

PUBLIKE



**USAID** | **KOSOVË**  
NGA POPULLI AMERIKAN



USAID/KOSOVË

# STRATEGJIA E BASHKËPUNIMIT PËR ZHVILLIM TË VENDIT (SBZHV)

13 MAJ, 2020 – 13 MAJ, 2025

E MIRATUAR PËR NJOFTIM PUBLIK

# AKRONIMET

OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
SBZHV	Strategjia e Bashkëpunimit për Zhvillim të Vendit
BMP	Bashkëpunimi, të Mësuarit dhe Përshtatja
MZK	Zyra e Menaxhimit dhe Zbutjes së Konfliktëve (USAID)
KFZH	Korporatë Financiare për Zhvillim
DQ	Demokracia dhe Qeverisja
DPZH	Demokracia për Zhvillim
DSH	Departamenti i Shtetit
DID	Departamenti i Drejtësisë
OZH	Objektiv Zhvillimor
MRV	Mobilizimi i Resurseve Vendore
MPIP	Mjedis i Përshtatshëm për Investime Private
BU	Bashkimi Europian
EULEX	Misioni i Bashkimit Europian për Sundim të Ligjit
EKZO	Zyra Ekzekutive
TFF	Tregjet Financiare Funksionuese
IHD	Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta
PFFP	Pjesëmarrja Femërore në Fuqinë Punëtore
TLLF	Transparenca dhe Llogaridhënia Fiskale
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
QK	Qeveria e Kosovës
QS	Qeveria e Serbisë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INL	Byroja për Cështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit
RN	Rezultat i Ndërmjetëm
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike
ANJ	Agjencia për Ndihmë Juridike
VAUM	Vende me të Ardhura të Ulëta ose Mesatare
LGBTI	Lesbikë, Gej, Biseksualë, Transgjinjorë dhe Interseks
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
M&E	Monitorimi dhe Evaluimi
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (QK)
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (QK)
MFT	Ministria e Financave dhe Transfereve (QK)
MD	Ministria e Drejtësisë (QK)
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
ZMP	Zyra e Marrëdhënieve me Publikun (DSH)

MFP	Menaxhimi i Financave Publike
ZRK	Zyra Rajonale e Kontraktimit (USAID)
KR	Korniza e Rezultateve (USAID)
SIL	Sundimi i Ligjit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (BE)
Nën-RN	Nën-Rezultat i Ndërmjetëm (USAID)
TIKA	Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim
PLT	Programi i Lidërsipit Transformues
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USCIRF	Komisioni i Shteteve të Bashkuara për Lirinë Fetare Ndërkombëtare
QSHBA	Qeveria e Shteteve të Bashkuara
USPSC	Kontraktor Amerikan i Shërbimeve Personale
USPSC-RH	Kontraktor i Shërbimeve Personale – Punonjës Banues i Përhershëm
ZHPGG	Zhvillimi dhe Prosperiteti Global i Grave
BB	Banka Botërore
FEB	Forumi Ekonomik Botëror
PDB	Projekti i Drejtësisë Botërore

# TABELA E PËRMBAJTJES

## **I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

- a. Qëllimi i SBZHV-së
- b. Përkushtimi dhe Kapaciteti
- c. Zgjedhjet Strategjike
- d. Korniza e Rezultateve

## **II. KONTEKSTI I VENDIT**

- a. Faktorët që Shquhen
- b. Vizioni i Vendit Partner
- c. Mësimet e Nxjerra nga Udhërrëfyesi i Vendit
- d. Plani i Tranzicionit

## **III. QASJA STRATEGJIKE**

- a. Marrëdhënia e Qeverisë së SHBA-ve me Qeverinë e Kosovës
- b. Shfrytëzimi i Burimeve të Kosovës
- c. Angazhimi i Sektorit Privat
- d. Roli i Shoqërisë Civile dhe Qytetarëve
- e. Përpjekjet e akterëve tjerë të QSHBA

## **IV. NARRATIVI I KORNIZËS SË REZULTATEVE**

- a. Deklarata mbi Qëllimin dhe Narrativi
- b. Deklarata mbi Rezultatet e Objektivave Zhvillimor dhe Narrativi
- c. Deklarata mbi Rezultatet e Ndërmjetme dhe Narrativi

## **V. MONITORIMI, VLERËSIMI, DHE MËSIMI**

## **VI. ANEKSET**



## I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

**Qëllimi i SBZHV-së:** Qëllimi që synon të arrij misioni i USAID-it në Kosovë në kuadër të Strategjisë së Bashkëpunimit për Zhvillim të Vendit 2020-2025 (SBZHV) është që **"Kosova të realizojë dividendën e saj demokratike dhe demografike përmes zgjidhjeve të cilave do t'u prijë vetë."** Për të arritur këtë qëllim, USAID-i do të përpiqet të rrisë llogaridhënien qeveritare dhe synojë shfrytëzimin e mundësive të reja demokratike dhe ekonomike. Suksesi në këto dy fusha do t'ia trasojë rrugën Kosovës për të përparuar në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë.

Misioni i USAID-it në Kosovë do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës (QK) të ndërtojë mbi arritjet e saj të konsiderueshme në formulimin e politikave dhe do të mbështesë përkushtimin e saj ndaj zbatimit të tyre. Për të tejkaluar korrupsionin, papunësinë dhe përkushtimin e dobët ndaj llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, Misioni i USAID-it në Kosovë do të synojë të përforcojë përkushtimin dhe kapacitetin e QK-së në nivele të ndryshme për të mundësuar, në mënyrë sa më efikase dhe eficiente, planifikimin, zbutjen, dhe reagimin e duhur ndaj nevojave ekonomike, demokratike dhe shoqërore.

Misioni i USAID-it në Kosovë do të bashkëpunojë me partnerë dhe shoqërinë civile për t'u krijuar mundësi shprehjeje zërave më pak të dëgjuar në shoqërinë kosovare, veçanërisht të rinjve, grave dhe grupeve minoritare, të drejtojnë të ardhmen e tyre. Misioni synon të angazhohet në mënyrë strategjike me sektorin privat për të kërkuar zgjidhje kreative dhe qasje të bazuara në treg. Lirimi i fuqisë së sektorit privat do të ndihmojë përballjen me presionet demografike dhe politike në rritje e sipër.

**Përkushtimi dhe Kapaciteti:** Megjithëse në Udhërrëfyesit<sup>1</sup> për vitin fiskal (VF) 2019 dhe VF 2020 mungojnë disa nga matjet kuantitative për Kosovën, ata qartazi tregojnë se Kosova pozicionohet fuqishëm në mesin e vendeve me të ardhura të ulëta ose mesatare, mirëpo kundrejt vendeve tjera të rajonit të cilit i përket, Kosova çalon nga spektri i rrugëtimin të saj drejt vetqëndrueshmërisë. Përkundër rritjes ekonomike solide të saj, zgjerimit të konsiderueshëm të infrastrukturës dhe përmirësimeve brenda mjedisit afarist, Kosova ende ka matje të ulëta krahasim me rajonin. Nën-dimensionet brengosëse të vetqëndrueshmërisë, në kuadër të Përkushtimit dhe Kapacitetit, tregojnë performancë të dobët në Qeverisje të Hapur dhe Llogaridhënëse, Zhvillim Gjithpërfshirës dhe Kapacitet të Qeverisë.

Hulumtimet shtesë përgjatë boshtit të **Përkushtimit** pasqyrojnë një gjendje në të cilën, përkundër një mjedisi afarist mjaft të fortë, vendi ende përballet me mangësi të konsiderueshme nga aspekti i Demokracisë Liberale, Qeverisë se Hapur dhe Hendekut

---

<sup>1</sup> Udhërrëfyesi i Kosovës për VF 2020 <https://selfreliance.usaid.gov/country/kosovo>

Ekonomik Gjinator<sup>2</sup>. Kosova vuan nga vullneti i dobët politik për të adresuar korrupsionin dhe nepotizmin, si dhe nga përgjegjshmëria joadekuatë e qeverisë. Logjikisht, angazhimi civil dhe mbikëqyrja më e madhe qytetare janë të nevojshme për të forcuar më tej demokracinë e Kosovës. Një shqetësim tjetër madhor është shkalla e pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore, e cila nuk tejkalon 30 përqindshin, gjë që e privon kombin nga një kapital i konsiderueshëm njerëzor dhe talent i cili do të mund të vëhej në funksion të forcimit të ekonomisë.

Sa i përket aspektit të **Kapacitetit** tek Udhërrëfyesi, anët e forta të Kosovës kryesisht gjenden brenda *Kapacitetit Qytetar* dhe *Kapacitetit të Shoqërisë Civile*. Anët e forta konkrete përfshijnë një shoqëri civile efektive, nivele mbresëlënëse të qasshmërisë në internet<sup>3</sup> dhe shkalla e lartë e shëndetit të fëmijëve. Shikuar nga prizmi i dobësive, vendi ballafaqohet me sfida në kuadër të *Kapacitetit të Qeverisë* dhe *Kapacitetit të Ekonomisë*. Kapaciteti i qeverisë së Kosovës për të zbatuar politika dhe për t'u ofruar shërbime cilësore qytetarëve mbetet i ulët. Kosova gjithashtu vuan nga diversifikimi i kufizuar i eksportit<sup>4</sup> dhe njëri nga BPV-të për kokë banori më të ulët në rajon. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, si në nivelin komunal ashtu edhe atë kombëtar, ngushtimi i hendekut të shkathtësive në mes të fuqisë punëtore dhe sektorit privat, dhe rritja e aftësisë së sektorit privat për të eksportuar produkte me vlerë të lartë, do të japë një kontribut të madh në drejtim të forcimit të kapacitetit të Kosovës.

**Zgjedhjet strategjike:** Misioni i USAID-it në Kosovë do të angazhojë QK-në, sektorin privat, shoqërinë civile, donatorët dhe komunitetet tjera, në fushat që ofrojnë potencialin më të madh për të ndërtuar vetqëndrueshmëri afatgjatë.<sup>5</sup>

Strategjia e re do t'i ripërcaktojë marrëdhëniet e USAID-it me qeverinë dhe qytetarët e Kosovës. Përderisa në të kaluarën Misioni punoi ngushtë me institucionet e Kosovës dhe partnerët vendor për të siguruar rezultate zhvillimore përmes formulimit të politikave, qasja e re përqëndrohet në zbatimin e politikave. SBZHV-ja e re do të përqëndrohet në nën-dimensionet e *Demokracisë Liberale*, *Qeverisë së Hapur*, *Efektivitetit të Qeverisë*, *Barazisë së Grupeve Shoqërore*, si dhe *Shoqërisë Civile* dhe *Efektivitetit të Mediave*, me një zhvendosje në qasje e cila do të sigurojë pronësi më të

---

<sup>2</sup> Udhërrëfyesi i Kosovës nuk ofron matje kuantitative për Qeveri të Hapur dhe Hendekun Ekonomik Gjinator përgjatë boshtit të Përkushtimit, megjithatë, Misioni (i USAID-it) ishte në gjendje të plotësojë zbrastësinë në të dhëna përmes hulumtimeve të gjera dhe të dhënave nga burime të pavarura dhe studime të cituara më tej në strategji.

<sup>3</sup> Amvisëritë me qasje në internet në Europë. Të dhënat tregojnë se Kosova është mbi mesataren europiane me 93% [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement\\_countries\\_-\\_information\\_and\\_communication\\_technology\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Enlargement_countries_-_information_and_communication_technology_statistics)

<sup>4</sup> Megjithëse Udhërrëfyesi i Kosovës nuk ofron matje kuantitative për *Të Sofistikuarit e Eksportit*, Misioni siguron të dhëna nga burime tjera përgjatë strategjisë mbi diversifikimin e eksportit në Kosovë.

<sup>5</sup> Pandemia COVID-19 paraqet një sfidë të paprecedent me pasoja socio-ekonomike. Pasi të ketë një bazë më të gjerë provash mbi ndikimin e drejtpërdrejtë të COVID-19 në ekonomi dhe strukturat socio-politike në Kosovë, Misioni, sipas nevojës, do t'i rishikojë supozimet, risqet dhe qasjet e tij të detajuara gjatë fazës së dizajnit të projektit. Misioni ka besim të plotë se qasja e tij strategjike do të forcojë qëndrueshmërinë e strukturave politike, shoqërore dhe ekonomike të Kosovës. Llogaridhënia institucionale, mundësitë e reja demokratike dhe ekonomike për të gjithë qytetarët, si dhe angazhimi i të rinjve, shoqërisë civile dhe sektorit privat, mbeten parimet thelbësore të Misionit në ndihmën e tij përparimit të Kosovës në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë.

madhe vendore. Strategjia e re do të konsolidojë arritjet e realizuara në kapacitetin institucional deri më sot dhe do të nxisë përkushtimin e Kosovës ndaj zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ tashmë të etabluar, duke punuar me shoqërinë civile, sektorin privat dhe të rinjtë për të promovuar kërkesë më të madhe për qeverisje të mirë.

Strategjia e re gjithashtu shqyrton më qëllimisht mundësitë që Kosova të financojë zhvillimin e saj vetanak. Misioni i USAID-it në Kosovë do të punojë drejtpërdrejt me QK-në për të ndihmuar në mobilizimin e niveleve të mjaftueshme të të hyrave publike për të adresuar më mirë nevojat zhvillimore të vendit, duke siguruar që fondet publike të shpenzohen në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive. Misioni gjithashtu planifikon të ndihmojë në krijimin e kushteve nën të cilat sektori privat mund të veprojë në mënyrë më efektive. Rrjedhimisht, orientimet programore të Misionit të USAID-it në Kosovë do të ndihmojnë në forcimin e mobilizimit të të hyrave vendore (MHV), menaxhimit të financave publike (MFP), transparencës dhe llogaridhënies fiskale (TLLF) dhe mjedisit të përshtatshëm për investime private (MPIP). Misioni vlerëson se mjedisi në Kosovë nuk është ende i gatshëm për tregje financiare funksionuese (TFF). Megjithatë, strategjia e re do të ndihmojë në kultivimin e një mjedisi ku TFF-të mund të kenë zhvillim të hovshëm në të ardhmen, duke krijuar një treg financiar të besueshëm i cili do të jetë i aftë të eliminojë pasigurinë për investitorët. Ndarazi, burime dhe qasje të ndryshme për financim të zhvillimit janë të domosdoshme për të ecur përpara në rrugëtimin drejt vetqëndrueshmërisë, prandaj Misioni i USAID-it në Kosovë do të ndjekë mundësitë për të shfrytëzuar burime që nuk janë të Qeverisë së SH.B.A.-ve në të gjitha aktivitetet e tij.

Për të maksimalizuar ndikimin e punës së tij, Misioni i USAID-it do të shfrytëzojë rreth 160 ngjarje publike që mesatarisht ka gjatë një viti si dhe besueshmërinë që gëzon, për të artikuluar një mesazh të qartë, strategjik dhe të fuqishëm i cili përforcon qasjen strategjike në kuadër të kësaj SBZHV. *Komunikimi Strategjik* është një lëndë lidhëse e shumë elementeve të kësaj SBZHV, sepse Misioni e njeh rëndësinë që ka ndikimi i tij përmes komunikimit.


Një nismë tjetër që është thelbësore për zbatimin e suksesshëm të strategjisë së re është *Krijimi i Partneriteteve Efektive dhe Reforma e Prokurimit*. Misioni ka filluar një projekt pilot të Nismës për Partneritetin e Ri (NPR)<sup>6</sup> dhe vazhdimisht hulumton rrugë që shpiejnë drejt diversifikimit të bazës së tij të akterëve.

Strategjia e re rreshtohet përkrah Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) të QSHBA-ve, Planit të Përbashkët Strategjik të Departamentit të Shtetit dhe USAID-it dhe Strategjisë së Integruar të Vëndit (SIV) për Kosovën, duke promovuar drejtësi, paqe dhe prosperitet. Objektivat e Misionit për një qytetari kosovar të cilës i shërbejnë më mirë institucionet e qeverisjes që janë llogaridhënese dhe efektive dhe për mundësi të rritura për pjesëmarrje gjithëpërfshirëse demokratike dhe ekonomike, janë në të njëjtën linjë me prioritetet e QSHBA-ve.

---

<sup>6</sup> Nisma për Partneritetin e Ri <https://www.usaid.gov/npi>

Komisioni i Shteteve të Bashkuara për Lirinë Fetare Ndërkombëtare (USCIRF) nuk ka identifikuar ndonjë rrezik apo kërcënim për lirinë fetare në Kosovë; Kosova nuk identifikohet si një vend i Rangut 1 ose Rangut 2 sipas Raportit të USCIRF<sup>7</sup> të vitit 2019. Megjithatë, për shkak se feja dhe përkatësia etnike në Kosovë shpesh ndërliiden, Misioni mbetet i mirëinformuar ndaj ndikimit të mundshëm dhe rolit të bashkësive fetare në bashkëpunimin ndëretnik.<sup>8</sup>



<sup>7</sup> <https://www.uscirtf.gov/reports-briefs/annual-report/2019-annual-report>

<sup>8</sup> <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/05/KOSOVO-2018-INTERNATIONAL-RELIGIOUS-FREEDOM-REPORT.pdf>



## II. KONTEKSTI I VENDIT

Që nga strategjia paraprake (2014-2018), Kosova ka vazhduar të përparojë nga aspekti i ndërtimit të institucioneve, trendeve ekonomike dhe pjesëmarrjes qytetare. Megjithatë, përparimi nuk ka qenë drejtvizor, dhe shumë kushte mbeten problematike. Faktorët e më poshtëm informuan zgjedhjet e bëra nga Misioni i USAID-it në Kosove për strategjinë e re:

Kuadri Ligjor i Sapothemeluar: Gjatë pjesës më të madhe të shekullit të njëzetë, Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë komuniste – me institucione të pazhvilluara të qeverisjes dhe një ekonomi të komanduar. Në vitin 1999, kur Kosova ishte vendosur nën një administratë të përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ajo u përball me shumë sfida, duke përfshirë përvojën e kufizuar me vetëqeverisje, nivele të ulëta të zhvillimit ekonomik dhe një popullsi dhe infrastrukturë të dëmtuar keq nga vite të luftës, shtypjes dhe armiqësive etnike. Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Megjithë faktin se gjatë dekadës së fundit vendi bëri përparim të konsiderueshëm në ndërtimin e institucioneve shtetërore, qeverisja e tij dhe sistemet ligjore janë ende në stadin fillestar të zhvillimit. Kosova themeloi një sistem juridik plotësisht autonom, me gjykata dhe prokurori që kanë personel vendor, për herë të parë në vitin 2019.

Demografia: Kosova është vendi më i ri i Europës me një popullsi prej 1.8 milion. Moshë mesatare është 26, ndërsa 38 përqind e popullsisë është më e re se 20 vjeç.<sup>9</sup> Nëse rriten mundësitë demokratike dhe ekonomike, rinia paraqet një burim të mirfilltë për prosperitetin e Kosovës. Një fuqi punëtore e re dhe e trajnuar mirë mund të jetë një avantazh krahasimor për forcimin e sistemeve demokratike dhe rritjen e shpejtë të produktivitetit. Në të kundërtën, mbingarkesa në ardhje e sipër e të rinjve do të rrisë tej mase presionin mbi infrastrukturën aktuale, sistemin e arsimit, ekonominë, shërbimet publike dhe stabilitetin politik. Duhet filluar me shfrytëzimin e këtij burimi qysh tani pasi nivelet e pjellorisë dhe shkalla e vdekshmërisë së fëmijëve tashmë kanë arritur nivelet e post-tranzicionit, dhe përpjesëtimet e varshmërisë do të bien. Siç shihet aktualisht në pjesën më të madhe të Europës, edhe popullsia e Kosovës do të përjetojë një zhvendosje të strukturës së moshës nga ajo shumë e re drejt një demografie më të moshuar. Dritarja e mundësisë që Kosova të realizojë dividendën e saj demografike është mjaft e ngushtë.

Zhënjimi i të rinjve paraqet sfida të konsiderueshme në Kosovë. Mbi të rinjtë rëndon barra e ndjenjës se pafuqishmërisë kundrejt realitetit të hidhur dhe perceptcionit të përhapur mbi korrupsionin në qeveri. Plagët psikologjike nga konfliktet e ndodhura relativisht rishtazi janë kudo, edhe nëse peizazhi përrreth është transformuar nga infrastruktura vezulluese. Kosova mbetet vendi i vetëm në Europë që ende nuk gëzon liberalizim të regjimit të vizave me Bashkimin Europian (BE), gjë e cila është bërë pengesë e konsiderueshme për udhëtimet e qytetarëve të Kosovës dhe ka implikime

<sup>9</sup> Banka Botërore: Diagnoza Sistemike e Vendit <http://documents.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/Kosovo-Systematic-Country-Diagnostic>

serioze për tregtinë dhe arsimin e lartë.<sup>10</sup> Situata aktuale paraqet mundësinë e fundit të mirë që i jepet Kosovës për të siguruar se rinia e saj do të angazhohet, ndikojë dhe bëhet katalizator i përmirësimit të qeverisjes dhe i prosperitetit të Kosovës.

Megjithëse Kosova ka pasur gra në pozicione kyçe, mbledhja e grave kosovare së bashku nëpër parti politike si një masë kritike për t'u angazhuar në çështje të përbashkëta ose për të shprehur përfundimisht pozicione politike dhe marrë vendime mbetet e kufizuar. Sipas një sondazhi të zhvilluar nga Demokracia për Zhvillim (D4D), 65 përqind e grave në Kosovë nuk janë përpjekur të përfshihen në ndonjë proces vendimmarrjeje dhe nuk besojnë se mund të kenë ndikim.<sup>11</sup> Përveç kësaj, hulumtimet tregojnë se asnjë vend në Europë nuk ka përpjestim më të ulët të grave në tregun formal të punës se Kosova. Sipas Bankës Botërore (BB), "me rreth 18 përqind, Kosova përballet me një nga nivelet më të ulëta të pjesëmarrjes femërore në fuqine punëtore në botë – ndjeshëm më të ulët se vendet tjera të Ballkanit Perëndimor."<sup>12</sup>

Megjithëse përbërja etnike e Kosovës është e shumëllojshme, komuniteti shqiptar i Kosovës përbën mbi 90 përqind të popullsisë ndërsa serbët e Kosovës përbëjnë rreth 7 përqind<sup>13</sup> të popullsisë.<sup>14</sup> Përderisa elitat politike shqiptare të Kosovës dhe serbe të Kosovës bashkëpunojnë në qeverisjen formale me shtetin dhe ndajnë burimet në nivelin qendror dhe atë lokal, qytetarët e rëndomte nga dy komunitetet kryesore jetojnë pothuajse në botëra paralele, me kontakte dhe komunikim minimal. Sipas Grupit Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve, një pjesë e pakicave jo-serbe të Kosovës, si Romë, Ashkali dhe Egjiptian, janë të zhytur në varfëri të thellë dhe vuajnë mungesën e sigurisë fizike dhe lirisë së lëvizjes. "Në vendbanimet e tyre të improvizuara, atyre u mungon qasja në arsim dhe shërbime publike, përfshirë kujdesin shëndetësor, qasjen në drejtësi dhe mundësitë për punësim."<sup>15</sup>

**Sektori Privat i Sapolindur:** Performanca joadekuate e institucioneve të qeverisjes paraqet një pengesë për rritjen ekonomike. Ekonomia e Kosovës bazohet tej mase në konsum, ndërsa remitencat përbëjnë rreth 16 përqind të BPV-së së saj.<sup>16</sup>

Firmat janë të vogla dhe u mungon ekspertiza për t'i identifikuar tregjet e huaja dhe eksportuar në to. Sektori publik i fryrë me paga të larta nga njëra anë dhe remitencat

---

<sup>10</sup>Sipas Indeksit Henley të Pasaportave, Kosova renditet 99/107 përnga qasja në udhëtim pa viza <https://www.henleypassportindex.com/passport>

<sup>11</sup> D4D, Përfshirja e grave dhe të rinjve në vendimmarrje dhe qeverisje lokale. [https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/D4D\\_PI\\_19\\_ENG\\_FINAL\\_web.pdf](https://d4d-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/D4D_PI_19_ENG_FINAL_web.pdf)

<sup>12</sup> Banka Botërore: Promovimi i Punësimit të Grave në Kosove. <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/promoting-women-employment-in-kosovo> Megjithatë, USAID-i konsideron se sondazhi mbi pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore i MCC-së, i cili konsideron pjesëmarrjen e grave jashtë ekonomisë formale, tregon një pjesëmarrje pak më të lartë të grave në fuqinë punëtore, deri në 25%.

<sup>13</sup> Analiza e Ekonomisë Politike e Kosovës, 2017

<sup>14</sup> Analiza e Ekonomisë Politike e Kosovës, 2017

<sup>15</sup> <https://minorityrights.org/minorities/roma-9/>

<sup>16</sup> Banka Botërore, Remitencat, Kosova: <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TR.FWKR.DT.GD.ZS?locations=XK>

nga ana tjetër, bëjnë që vendet e punës në sektorin privat të jenë më pak tërheqëse. Klima e dobët e investimeve, furnizimi i pamjaftueshëm dhe i pasigurtë me energji elektrike, favorizimi politik dhe fuqia punëtore me mungesë të shkathtësive adekuate, dekurajojnë investitorët dhe pengojnë zhvillimin e një sektori privat konkurent. Sipas Analizës së Ekonomisë Politike të Kosovës, të vitit 2017, një zemërim në rritje e sipër tek të rinjtë po manifestohet në formë të braktisjes nga ana e tyre të vendit për mundësi që përceptohen si më të mira diku tjetër. Kosova mbetet vendi i tretë më i varfër në Europë, me një BPV për kokë banori që është afërsisht 11 përqind e mesatares së BE-së.<sup>17</sup>

Stabiliteti Rajonal dhe Aderimi në BE: Ngecjet e kohëve të fundit sa u përket njohjeve ndërkombëtare të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur ka acaruar më tej sfidat e shumta me të cilat ballafaqohet Kosova.

Pesë vende anëtare të BE-së ende nuk e njohin Kosovën. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) të cilën Kosova e nënshkroi me BE-në si parakusht për t'u anëtarësuar në BE, përmban reforma sfiduese politike dhe ekonomike që duhet realizuar.

Këta faktorë ndikojnë negativisht në investimet e huaja direkte (IHD), eksportin e Kosovës, lirinë e udhëtimit, anëtarësimin e saj në organizata tjera ndërkombëtare, etj.

**Vizioni i Vendit Partner.** Sipas *Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit* të fundit nga Transparency International, Kosova po përjeton një zhvendosje brenda pushtetit legjislativ, e cila mund të ofrojë një rast të mirë për t'i zhbërë mangësitë e udhëheqjes paraprake dhe prioritetizuar përpjekjet anti-korrupsion.<sup>18</sup> Për herë të parë, kreu i Kuvendit të Kosovës është një grua, një e treta e deputetëve janë gra, ndërsa pesë nga 15 pozitat ministrore në QK mbahen nga gratë.

Prioritetet e nënvizuara nga QK në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021 dhe në Strategjinë e saj Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016 përputhen me objektivat e USAID-it: industri konkurente, qeverisje transparente, siguri energjetike, lidhje më të mira në mes të sistemit arsimor dhe tregut të punës për të krijuar vende pune, dhe ngushtim të hendekut ekonomik gjinor. Ekzistojnë një sërë masa nxitëse ku Misioni i USAID-it në Kosovë do të ketë mundësi të kërkojë përkushtimin e QK-së ndaj llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë. Këto ndryshime premtuese kanë potencialin t'i japin një shtytje të fuqishme Kosovës drejt një transformimi të pashembullt.

USAID-i mbetet një partner i dëshmuar në sukseset e Kosovës. USAID-i i doli në ndihmë Kosovës dhe e mbështeti atëherë kur ajo kishte nevojat më urgjente për ndihmë, si një shtet i pavarur i sapokrijuar. Gjate viteve, USAID-i ka qëndruar i palëkundur në mbështetjen e tij duke dyfishuar përpjekjet për të adresuar sfidat e ngutshme, por tashmë edhe duke u tërhequr kur është nevoja, pasi që Kosova gjithnjë e më shumë po merr mbi vete realizimin e detyrës së përparimit në rrugëtimin e saj drejt

<sup>17</sup> Banka Botërore BPV për kokë banori: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

<sup>18</sup> [https://www.transparency.org/news/feature/cpi\\_2019\\_global\\_highlights](https://www.transparency.org/news/feature/cpi_2019_global_highlights)

vetqëndrueshmërisë. Nuk ka asnjë mëdyshje se këto përpjekje janë shpaguar. Kosova mbetet një nga mbështetësit më të zëshëm të Amerikës dhe aleatët më të qëndrueshëm.

**Udhërrëfyesi i Vendit.** Kosovës i mungojnë disa nga matjet kuantitative univerzale në Udhërrëfyetit<sup>19</sup> për VF 2019 dhe VF 2020. Megjithatë, të dhënat plotësuese nga burime tjera dëshmojnë për një kapacitet të përgjithshëm të favorshëm kundrejt niveleve globale dhe niveleve mesatare të përkushtimit.

Megjithëse Udhërrëfyesi e tregon Kosovën të jetë mbi mesatare nga aspekti i shumicës së matjeve kuantitative për vendet me të ardhura të ulëta ose mesatare (VAUM), Kosova ngec në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë krahasuar me vendet relativisht të ngjashme të rajonit. Fushat brengosëse janë *Qeverisja e Hapur dhe Llogaridhënëse, Zhvillimi Gjithpërfshirës, dhe Kapaciteti i Qeverisë*. Përderisa Udhërrëfyetit i mungojnë dy vlera të matjeve kuantitative nën *Kapacitetin e Ekonomisë*, Misioni është i bindur se matjet kuantitative vijuese meritojnë një vështrim më nga afër: BPV për kokë banori dhe *Sofistikimi i Eksportit*.

Nën Përkushtimin, të dhënat tregojnë se përderisa legjislativi dhe formulimi i politikave në Kosovë kanë kaluar një rrugë të gjatë, veprimet e qeverisë dhe normat shoqërore tregojnë se ende ka mungesë të gatishmërisë për zbatim konsistent të ligjeve dhe politikave, gjë e cila frenon rrugëtimin drejt vetqëndrueshmërisë.

*Qeverisja e Hapur dhe Llogaridhënëse:* Parakushti më i rëndësishëm për avancimin e vetqëndrueshmërisë është një qeveri më llogaridhënëse dhe e përgjegjshme ndaj qytetarëve. Korrupsioni, kapja e shtetit dhe interesat e fshehta kanë çuar në abuzim të burimeve vendore, ndërsa konvergimi i interesave ekonomike dhe politike çon në transaksione jotransparente që si pasojë e privojnë Kosovën nga potenciali për zhvillim në të ardhmen.

Paralelisht me realitetin në terren, Udhërrëfyesi tregon se *Demokracia Liberale* rezulton me vlerën më të ulët në Udhërrëfyetin e Kosovës. Nëse shikohen matjet kuantitative dytësore nga Varietetet e Demokracisë, Kosova duket të ketë më së shumti vështirësi nën Indeks të Demokracisë Liberale dhe atë të Demokracisë Pjesëmarrëse, duke shënuar gjithsej 37/45 në nivel rajoni.<sup>20</sup>

*Qeveria e Hapur:* Të dhënat alternative tregojnë se Kosova me sukses futi reformat e transparencës në disa sektorë, siç është prokurimi publik, falë partnerëve të gatshëm qeveritar, organizatave aktive të shoqërisë civile (OSHC), mediave dhe mbështetjes së USAID-it. Përderisa ky është një trend pozitiv i transparencës, mbetet ende shumë për të bërë për ta bërë qeverinë e Kosovës vërtetë llogaridhënëse, si në nivelin qëndror ashtu edhe atë komunal.

<sup>19</sup> Udhërrëfyeti I Vendit për Kosovën VF 2020 <https://selfreliance.usaid.gov/country/kosovo>

<sup>20</sup> IDEA Tabela e Vendit, matjet dytësore: <https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/democracy-human-rights-and-governance/good-governance>



*Barazia e Grupeve Shoqërore:* Kosova është nën mesataren e VAUM për nga mbrojtja e barabartë e lirive qytetare përgjatë vijave ndarëse etnike, fetare, racore, rajonale, etj. Konkluzione të ngjashme dalin edhe nga të dhënat e Freedom House<sup>21</sup>, duke pasqyruar një mospërputhje midis ligjit dhe realitetit në terren. Sipas treguesve të Varieteteve të Demokracisë që kanë të bëjnë me gjithpërfshirjen politike, përkatësisht nëse mbrojtja e barabartë, qasja në pushtet politik dhe shpërndarja e resurseve janë të disponueshme për të gjithë qytetarët pa dallim, Kosova rezulton të ketë një rangim të pafavorshëm në vendin e 120-të ose më ulët globalisht, nën mesataren Ballkanike.<sup>22</sup> Për më tepër, sipas Raportit të Bankës Botërore, perceptimi i pranueshmërisë së përgjithshme të personave LGBTI është më i keqi në Kosovë krahasuar me vendet tjera të Europës Juglindore.<sup>23</sup>

Megjithëse matjet kuantitative për Hendekun Ekonomik Gjinator nuk janë të disponueshme në Udhërrëfyes, burime të tjera tregojnë të dhëna brengosëse. Sondazhi i fundit i Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) mbi Fuqinë Punëtore dhe Përdorimin e Kohës thekson, "Me gjithë faktin se rinia përfaqëson një aset të vlefshëm ekonomik, me një shkallë punësimi prej vetëm 27.7 përqind, potenciali i tyre mbetet i nën-shfrytëzuar. Kjo veçanërisht vlenë për femrat e reja, meqë vetëm një nga gjashtë është e punësuar."<sup>24</sup> Megjithëse ne zbeheje e sipër, disa mbetje të normave zakonore ende ndikojnë në barazinë gjinore<sup>25</sup> dhe i vëjnë gratë në disavantazh kur bëhet fjalë për qasjen dhe kontrollin mbi burimet financiare. Një nga këto norma zakonore ka të bëjë me pronën dhe të drejtat trashëgimore së grave. Sipas *Raportit të Lirisë në Botë 2019* nga Freedom House, "me gjithë faktin se ligji thotë që trashëgimia duhet të ndahet në mënyrë të barabartë midis trashëgimtarëve meshkuj dhe femra, qëndrimet e forta patriarkale ushtrojnë presion ndaj grave për të hequr dorë nga të drejtat e tyre në favor të anëtarëve meshkuj të familjes."<sup>26</sup>

*Kapaciteti Qeveritar dhe Kapaciteti i Ekonomisë:* Misioni i USAID-it në Kosovë kombinon indikatorët kyq nga të dyja nën-dimensionet si thjerrëz përmbledhëse për ta avancuar Kosovën drejt vetqëndrueshmërisë: *Efektiviteti i Qeverisë, BPV për kokë banori dhe Sofistikimi i Eksportit*. Rritja e konsiderueshme ekonomike në Kosovë duhet vështruar përmes thjerrëzës së qeverisjes. Sipas treguesit të Bankës Botërore (BB) mbi Efektivitetin e Qeverisë, Kosova rezulton e ranguar diku në fund të listës së vendeve Ballkanike dhe nuk ka treguar ndonjë përmirësim madhor që kur BB filloi t'i

<sup>21</sup> <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/kosovo>

<sup>22</sup> [https://www.v-dem.net/media/filer\\_public/3f/19/3f19efc9-e25f-4356-b159-b5c0ec894115/v-dem\\_democracy\\_report\\_2018.pdf](https://www.v-dem.net/media/filer_public/3f/19/3f19efc9-e25f-4356-b159-b5c0ec894115/v-dem_democracy_report_2018.pdf)

<sup>23</sup> <http://documents.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf> (page 3).

<sup>24</sup> <https://data.mcc.gov/evaluations/index.php/catalog/205/study-description>

<sup>25</sup> E drejta zakonore është e dokumentuar kryesisht në Gjeçovi, Shtjefën, Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1910-1925

<sup>26</sup> <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2019/kosovo>

përcjellë zhvillimet në vitin 2006.<sup>27</sup> Presioni politik ndikon negativisht në cilësinë e shërbimeve publike, shërbimit civil, si dhe formulimit dhe zbatimit të politikave. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve, si në nivel nacional ashtu edhe atë komunal, duke mbajtur njëkohësisht kërkesën e qytetarëve aktive, do të forcojë kontratën shoqërore të sapolindur.

Sipas Raportit të Tregtisë së Jashtme të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) nga janari i vitit 2019, eksporti mbulon importin me 12.3 përqind.<sup>28</sup> Mallërave që eksportohen nga Kosova gjithashtu u mungon diversiteti dhe cilësia e mirë: sipas Trading Economics, Kosova kryesisht eksporton metale (47 përqind e totalit të eksporteve) dhe produkte minerale (30 përqind e totalit të eksporteve).<sup>29</sup> Raporti Diagnostifikues i Vendeve të Punës i Bankës Botërore vlerëson se "Kapaciteti prodhues i Kosovës po rritet, por është i ngushtë, i padiversifikuar dhe jokonkurent."<sup>30</sup>

**Planifikimi i Tranzicionit:** Kosova ka një kuadër ligjor të fortë, shoqëri civile të gjallërishme dhe ekonomi të tregut në ngritje e sipër, gjëra këto që gjenerata e refugjatëve të para 20 viteve nuk do të mund t'i imagjinonte. Sfidat e ditëve të sotme konsistojnë në ndërtimin mbi rezultatet e konsiderueshme të arritura dhe dhënien e një shtytjeje llogaridhënies nga ana e institucioneve qeverisëse ndaj qytetarëve të Kosovës, dhe krijimi i mundësise për pjesëmarrje gjithpërfshirëse demokratike dhe ekonomike. Gjatë jetës së kësaj strategjie, orientimet programore të USAID-it do të ndihmojnë që këto rezultate të konsiderueshme të arritura të bëhen të pazhbërëshme. Institucionalizimi i reformave, plotësimi i boshllëqeve dhe zbutja e hapave të bërë prapa, do të çojë drejt një demokracie dhe ekonomie të vetqëndrueshme të Kosovës.

Në kombinim me donatorët tjerë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe angazhimin e gjerë qytetar, Misioni synon përparim të konsiderueshëm në arritjen e vetqëndrueshmërisë në nivelin lokal dhe nacional përmes rezultateve transformuese dhe të qëndrueshme në: përgjegjshmërinë e institucioneve të drejtësisë dhe të qeverisjes ekzekutive si dhe përgjegjshmërinë e legjislativit, kontributin e qytetarëve demokracisë dhe ekonomisë, konkurrencën e sektorit privat dhe përmirësimin e sigurisë energjetike.

### III. QASJA STRATEGJIKE

Në vitin 2020, sfida zhvillimore e Kosovës është përkushtimi i saj i brishtë institucional ndaj llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë, i cili pengon mundësitë demokratike dhe ekonomike. Zbatimi jokonsistent i legjislativitetit dhe rregullave pamundëson fleksibilitetin

---

27

[https://tcdata360.worldbank.org/indicators/h1c9d2797?country=KSV&indicator=388&countries=ALB,SRB&viz=line\\_chart&year=1996,2018](https://tcdata360.worldbank.org/indicators/h1c9d2797?country=KSV&indicator=388&countries=ALB,SRB&viz=line_chart&year=1996,2018)

<sup>28</sup> <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/international-trade-statistics-january-2019>

<sup>29</sup> <https://tradingeconomics.com/kosovo/exports>

<sup>30</sup> <http://documents.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/ACS21442-WP-PUBLIC-ADD-SERIES-KosovoJWEB.pdf>

ekonomike dhe kohezionin shoqëror, duke privuar më tutje Kosovën dhe qytetarët e saj nga realizimi i potencialit të tyre të plotë. Interesat politikë dhe ekonomikë në Kosovë janë shndërruar në një konvergjencë interesash të kundërvëna, që nxitë korrupsionin dhe frenon zhvillimin e sektorit privat.

Shikuar drejt së ardhmes, vizioni i Misionit për trashëgiminë që do të lë USAID-i në Kosovë është ai i një gjenerate të pasluftës e cila respekton të kaluarën, por ka një vizion për të ardhmen që është multi-etnik, i bazuar në sundim të ligjit dhe në ekonomi konkurente të tregut. Përparimi i bërë gjatë 20 viteve të fundit ka qenë i konsiderueshëm dhe i pa ekuivokë, por Kosova nuk është aty ku duhet të jetë në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë. Misioni i USAID-it në Kosovë do të ndihmojë QK-në dhe qytetarët e Kosovës duke u përqëndruar në llogaridhënie për vendimmarrësit dhe duke gjeneruar mundësi demokratike dhe ekonomike për të gjithë qytetarët. Ajo që i përshkon këto prioritete kryesore është një fokus i qëllimshëm në zhvillimin gjithpërfshirës dhe mbështetjen për ndërtimin e identitetit kombëtar të Kosovës.

Komunikimi strategjik është thelbësor në operacionalizimin e një strategjie që është e përqëndruar tek qytetarët dhe që vë theksin në zgjidhjet të cilave u prinë Kosova. Gjatë jetës së strategjisë, Misioni do të ekzekutojë plane strategjike të komunikimit për të drejtuar përpjekjet e tij të komunikimit përreth objektivave të drejtpërdrejta (OD-ve), me mesazhe konkrete për të përforcuar vetqëndrueshmërinë. Plani do të rishikohet çdo vit për të ndërtuar mbi sukseset dhe mësimet e nxjerra nga viti paraprak, duke amplifikuar mesazhe të reja ose të përdorura më parë, sipas nevojës.

Misioni shqyrtoi gjetjet nga Analiza e Pylltarisë dhe Biodiversitetit 119<sup>31</sup> e realizuar më parë me qëllim që të evitojë çfarëdo humbje të pariparueshme që do të kishte pasoja potencialisht serioze mjedisore dhe ekonomike për Kosovën. Gjetjet kryesore tregojnë se, përkundër ligjeve të mira për pylltarinë dhe biodiversitetin, zbatimi joadekuat i legjisllacionit për shkak të mungesës së buxhetit të mjaftueshëm por edhe për shkak të numrit të pamjaftueshëm të personelit të trajnuar, pengojnë ruajtjen e biodiversitetit të Kosovës. Misioni beson se biodiversiteti i Kosovës mundet vetëm të përfitojë nga zbatimi i llogaridhënies dhe efektiviteti i institucioneve qeveritare (OD1).

***Marrëdhënia me Qeverinë e Kosovës:*** Qeveritë e Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës kanë një marrëdhënie të shkëlqyeshme dhe partneritet të qëndrueshëm në programimin e zhvillimit. Megjithatë, për të siguruar që Kosova të marrë përsipër pronësinë mbi agjendën e saj zhvillimore dhe rolin prijës në ndjekjen e saj, Misioni tashmë ka krijuar praktika dhe mekanizma për të *ridefinuar marrëdhënien e tij* me Kosovën. Misioni ka nënshkruar një kontratë të veçantë përmes Marrëveshjeve të tij mbi Objektivat Zhvillimor (MGOZH) me QK-në për të pasqyruar një plan zhvillimor me objektiva të përbashkët për partneritet në Buxhetin Vjetor të Kosovës. Krahas kësaj,

---

<sup>31</sup> [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00WCZP.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00WCZP.pdf)

Misioni synon të nxisë vullnetin politik duke u angazhuar me shoqërinë civile, sektorin privat dhe donatorët tjerë.

Misioni i USAID-it në Kosovë ka shtuar dhe plotësuar kapacitetin e institucioneve të QK-së, përfshirë përmes sigurimit të këshilltarëve rezident. Tani, Misioni qëllimisht po lëvizë drejt një marrëdhënieje partneriteti me QK-në për të theksuar rëndësinë e marrjes përsipër të pronësisë nga ana e Kosovës. Misioni i USAID-it në Kosovë do të bëjë tranzicion drejt ofrimit të ndihmës teknike afatshkurtër kritike kur ajo të jetë e nevojshme, me kusht që QK-ja të mundësojë transferimin e teknologjisë tek shërbyesit civilë, dhe më tutje të përfshijë kostot e tyre në buxhetin e QK-se. Misioni i USAID-it në Kosovë nuk parasheh mbështetjen e këshilltarëve rezident afatgjatë në QK.

Plani konsiston në identifikimin e mundësive, përmes strategjisë së re, për të përdorur ndikimin kolektiv të donatorëve tjerë dhe partnerëve implementues. Misioni i USAID-it në Kosovë tashmë i ka priorë komunitetit ndërkombëtar të donatorëve në përfundimin tek udhëheqësit e rinj të QK-së e parimeve thelbësore të efektivitetit të ndihmës, përfshirë marrjen përsipër nga QK të pronësisë për të programuar, zbatuar dhe monitoruar bashkërendimin e ndihmës së donatorëve me prioritetet e qeverisë.

**Shfrytëzimi i Burimeve të Vendit Nikoqir.** Megjithëse QK ka hartuar një numër të konsiderueshëm dokumentesh strategjike të sofistikuar, shumë prej të cilave janë në përputhje me prioritetet tona, kapaciteti dhe përkushtimi i akterëve gjegjës qeveritar për t'i zbatuar ato në mënyrë të koordinuar lë për të dëshiruar. Përkundër faktit se donatorët bashkëpunojnë në mes vete, shumë donatorë kërkojnë strategji të Ministrive ose sipas sektorit, gjë e cila rezulton me një kakofoni dokumentesh strategjike, e cila e tërheqë kapacitetin e QK-së gjithandëj duke e tëholluar në atë masë sa të mos jetë në gjendje t'i zbatojë ato.

Si përgjigje, Misioni i USAID-it në Kosove është i vendosur që të ndihmojë QK-në në përmbushjen e prioritetëve të saj ekzistuese të përcaktuara në buxhetin e Kosovës. Misioni synon të mbikqyrë nga afër Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës – një ushtrim vjetor i buxhetimit për tërë qeverinë, i cili pasqyron prioritetet strategjike të QK-së dhe përdoret si përcaktues kyq për implementimin e prioritetëve të QK-së.<sup>32</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (2019-2021) u përgjigjet prioritetëve të përshkruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (2016-2021), Programin për Reforma në Ekonomi 2019-2021,<sup>33</sup> dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Përveç kësaj, Misioni i USAID-it në Kosovë është duke u angazhuar me donatorë tjerë në koordinimin e përpjekjeve për të mos e tejngarkuar QK-në me një numër të tepërt prioritetesh konkurente. Për shembull, Misioni ka një Memorandum të Mirëkuptimit me BE-në në sektorin e sundimit të ligjit, ku përcaktohet mbështetja e secilit nga donatorët për këshillat gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

<sup>32</sup> <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/F41E6181-8CC0-4E79-A797-B5B5FEBCD82A.pdf>

<sup>33</sup> GOK tashmë ka aprovuar PRE (2020-2022) dhe së shpejti do ta paraqesë atë në BE.



QK vazhdon të theksojë rëndësinë e stabilitetit makroekonomik dhe fiskal si parakusht për krijimin e një klime më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat. QK përcakton përkushtimin e tij për forcimin e stabilitetit makro-fiskal duke 1) siguruar ekuilibrin e domosdoshëm në mes të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, 2) siguruar që deficitin buxhetor është brenda kuadrit ligjor, ndërsa rritja e borxhit publik si derivat i këtij deficiti mbahet nën kontroll dhe në nivele stabile, dhe 3) mbajtur një nivel të mjaftueshëm të rezervave buxhetore për t'u përballur me risqe fiskale të jashtme dhe të brendshme.

Bazuar në Udhërrëfyesit për VF 2019 dhe VF 2020, Misioni sheh mundësi për ta avancuar Kosovën në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë duke u përqëndruar në ndërtimin e *Kapacitetit të Qeverisë* dhe *Kapacitetit të Ekonomisë*, dhe siguruar përkushtimin e Kosovës ndaj *Qeverisjes së Hapur* dhe *Llogaridhënës* dhe *Zhvillimit Gjithpërfshirës*.

Në partneritet me QK-në, sektorin privat dhe shoqërinë civile të Kosovës, Misioni i USAID-it në Kosovë do të zvogëlojë si dhe thjeshtojë dhe racionalizojë rregullat dhe procedurat që janë shpesh të ngurta e të mundimshme për të bërit biznes në Kosovë, duke forcuar kapacitetin e institucioneve për t'u bërë më efiçente, duke ndërtuar kapacitete për të planifikuar dhe gjeneruar të hyra për nevojat zhvillimore vetanake, dhe zvogëluar boshllëqet dhe mangësitë që nxisin korrupsionin dhe/ose proceset jotransparente.

**Angazhimi i sektorit privat:** Misioni e sheh sektorin privat si një partner të rëndësishëm në arritjen e rezultateve zhvillimore. Me strategjinë e re, Misioni i USAID-it në Kosovë do të forcojë kapacitetet e sektorit privat për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Përveç kësaj, Misioni planifikon ta angazhojë sektorin privat si partner për ide inovative lidhur me reformën e qeverisjes, mjedisin e përshtatshëm për biznes dhe reformën energjetike, si dhe për ide që kanë të bëjnë me nxitjen e angazhimit aktiv të të rinjve, grave dhe minoritarëve. Në frymën e inkurajimit të vetqëndrueshmërisë, Misioni gjithashtu do të synojë të gjej mundësi për të shfrytëzuar burimet ekzistuese të sektorit privat vendor për të bashkëfinancuar nismat zhvillimore të Kosovës dhe bashkëkrijuar zgjidhje të qëndrueshme për rritje.

Përderisa Misioni angazhon sektorin privat si një partner të barabartë me financa, ide dhe kapacitete për të gjetur zgjidhje, ai në të njëjtën kohë promovon zhvillimin e sektorit privat duke u fokusuar në nxitjen e tij për të gjeneruar më shumë mundësi ekonomike për të rinjtë e Kosovës. Një grup me madhësi të konsiderueshme që zë vend me rëndësi në peizazhin e sektorit privat të Kosovës është diaspora e Kosovës, me të cilën ekziston potenciali për bashkëpunim strategjik.

Për të patur rritje të qëndrueshme ekonomike, Misioni do të promovojë lidhjet në mes të sektorit privat dhe tregjeve të reja, do t'i japë shtytje dialogut produktiv në mes të sektorit privat dhe qeverisë, si dhe do të identifikojë akterë të rinj dhe ekzistues dhe shoqata të tjera të industrisë që kanë potencial të lartë për rritje. Misioni do t'i shfrytëzojë shanset e reja dhe mundësitë në rritje e sipër në kuadër të *Qeverisë së*

*Hapur, Hendekut Ekonomik Gjinator, Diversifikimit të Eksportit dhe BPV për kokë banori.* Përpjekjet do të vëne theksin tek të rinjtë dhe gratë, për të siguruar që gjeneratat e ardhshme të mund të marrin pjesë aktive në një ekonomi konkurente dhe demokraci gjithpërfshirëse.

**Roli i shoqërisë civile dhe qytetarëve:** Shoqëria civile ka rëndësi fundamentale për një demokraci funksionuese dhe të gjallërishtme. Ajo luan rol kyq në përforsimin e zërit të qytetarëve të Kosovës për të siguruar që zyrtarët qeveritar të jenë llogaridhënës dhe të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve, si dhe në ndërtimin e besimit për nismat dhe ndikimin qytetar. Përgjithësisht, Kosova ka një shoqëri civile të larmishme dhe të zëshme që gëzon besim të konsiderueshëm te publiku dhe është relativisht e lirë nga shtypja me të cilën përballen disa nga simotrat e saj në rajon.<sup>34</sup> Misioni i USAID-it në Kosovë do ta shfrytëzojë fuqinë relative të *Shoqërisë Civile dhe Efektivitetit të Mediave* në Kosovë për të punuar me OSHC-të vendore dhe mediat në mbledhjen e partnerëve dhe burimeve vendore me qëllim të adresimit dhe gjetjes së zgjidhjeve për sfidat zhvillimore të Kosovës.

**Përpjekjet e akterëve tjerë të QSHBA:** Qëllimi parësor i ndihmës së QSHBA-së në Kosovë është të mbështesë integrimin Euro-Atlantik duke ndërtuar institucione qeveritare transparente dhe të përgjegjshme, inkurajuar rritjen ekonomike dhe themeluar institucione të sigurisë që janë nën kontrollin demokratik.<sup>35</sup>

Për të kapërcyer sfidat ndaj realizimit të këtij qëllimi, USAID-i dhe agjencitë tjera të QSHBA-së bashkëpunojnë për të promovuar sundimin e ligjit, zvogëluar korrupsionin në të gjitha hallkat e qeverisë, mënjeluar pengesat ndaj rritjes ekonomike, nxitur një shoqëri civile të fuqishme, përparuar sektorin energjetik, dhe forcuar kapitalin njerëzor, veçanërisht në mesin e të rinjve.

Departamenti i Shtetit (DSH) dhe USAID-i bashkëpunojnë ngushtë për t'u angazhuar me QK-në në promovimin e sundimit të ligjit dhe të një mjedisi qeverisës më të përshtatshëm për zhvillim. Seksioni Ekonomik i Ambasadës së SHBA-ve dhe USAID-i punojnë në çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, veçanërisht në përmirësimin e mjedisit afarist, rritjen e IHD-ve dhe ndërtimin e sektorit privat të sapolindur të Kosovës.

“Programi i Pragut” i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) në Kosovë dhe portofoli i Misionit të USAID-it në Kosovë janë komplementarë. Përderisa USAID-i është i përqëndruar në gjenerim të energjisë së re dhe diversifikim, MCC është e përqëndruar në efikasitetin energjetik, shpërndarjen dhe eksplorimin për infrastrukturë të gazifikimit të domosdoshme për sigurinë energjetike të Kosovës. Misioni i USAID-it në Kosovë gjithashtu bashkëpunon me Seksionin për Marrëdhënie me Publikun (PAS)

---

<sup>34</sup> Indeksi i Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile 2018

<https://www.fhi360.org/sites/default/files/media/documents/resource-csosi-2018-report-europe-eurasia.pdf>

<sup>35</sup> Strategjia e Integruar e Vëndit (ICS), Kosove 2018 [https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/01/EUR-Kosovo\\_UNCLASS\\_508.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2019/01/EUR-Kosovo_UNCLASS_508.pdf)

në një sërë aktiviteteve, veçanërisht në sektorin e arsimit dhe në mesazhet strategjike që nxjerrin në pah prioritetet e përgjithshme zhvillimore dhe të politikës së jashtme të QSHBA-së. Me qëllim të forcimit të lidhjeve në mes të institucioneve të gjyqësorit, Misioni i USAID-it në Kosovë koordinohet me Byronë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe me Zyrën për Zhvillim, Ndimë dhe Trajnim Prokurorial të Jashtëm (OPDAT). USAID-i gjithashtu koordinohet me Departamentin e Mbrojtjes për të siguruar që programet plotësojnë njëri tjetrin.

Përtej QSHBA-së, Misioni i USAID-it në Kosovë në mënyrë aktive hyn në partneritet me QK-në, sektorin privat të Kosovës, dhe donatorët tjerë me qëllim të rritjes dhe mirëmbajtjes së ndikimit zhvillimor të ndihmës së tij. Këto partneritete vendore, përveç që bëhen asete të cilat forcojnë investimet tona, bëhen edhe faktorë që avancojnë dhe promovojnë rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë.

## IV. KORNIZA E REZULTATEVE

### QËLLIMI:

Qëllimi i SBZHV-së së Misionit të USAID-it në Kosovë 2020-2025 është që **“Kosova të realizojë dividendën e saj demokratike dhe demografike përmes zgjidhjeve të cilave do t’u prijë vetë.”** Rëndësi themelore për realizimin e qëndrueshem të këtij qëllimi kanë dy objektiva zhvillimor (OZH): 1) qytetarët shërbehen më mirë nga institucionet llogaridhënëse dhe efektive të qeverisjes dhe 2) rriten mundësitë për pjesëmarrje gjithpërfshirëse demokratike dhe ekonomike. Këta OZH, të ndërthurur brenda tërësisë së kornizës sonë të rezultateve, do t’i mundësojnë Kosovës që të adresojë më mirë sfidat e veta zhvillimore në afat të gjatë.

OZH-të e propozuar janë komplementarë, dhe bashkërisht nxisin një mjedis i cili fuqizon zgjidhjet e prira nga Kosova. Nuk mjafton të ndërtohet institucione demokratike dhe të krijosh procese; ato duhet të rezultojnë më mundësi për qytetarët që të kenë jetëra produktive. OZH-të e Misionit adresojnë aspekte të ndryshme të angazhimit të qytetarëve. Objektivi zhvillimor (OZH) 1 përqëndrohet në mbikëqyrjen e qeverisë nga ana e qytetarëve dhe shoqërisë civile, ndërsa OZH 2 adopton një qasje më të gjërë ndaj pjesëmarrjes demokratike ku synon të përmirësojë bashkëpunimin në mes të qytetarëve, shoqërisë civile, bizneseve dhe sektorit publik në mënyrë që komunitetet lokale të jenë më mirë të pozicionuara për të adresuar sfidat zhvillimore të Kosovës.

Për të realizuar këtë qëllim, Misioni i USAID-it në Kosovë ka parasysh rëndësinë e çështjeve të poshtëshënuara, që duhet të jenë të ndërthurura përgjatë zbatimit të SBZHV-së, dhe të cilat kishin rëndësi parësore në të menduarit e Misionit, gjatë kohës që ai zhvilloi Kornizën e tij të Rezultateve (KR):

- **Gjithpërfshirja:** Nxitja e një mjedisi ku *të gjithë* qytetarët ndjehen të qetë dhe të lirë për t’u angazhuar në mënyrë aktive në sferën demokratike apo atë ekonomike në Kosovë.

- **Identiteti:** Promovimi i një imazhi të Kosovës me të cilin qytetarët e saj dëshirojnë të identifikohen pa hezituar, përmes mbjelljes së besimit në institucionet qeverisëse, eksportit të produkteve me cilësi të lartë të prodhuara në Kosovë, dhe përfaqësimit pozitiv nga ana e sportistëve, artistëve, etj.
- **Sensitiviteti ndaj konfliktit:** Shmangja nga rëndimi i paqëllimshëm i ndarjeve dhe ndjenjave të padrejtësisë të cilat mund të nxisin konflikte, duke ndërtuar njëkohësisht mbi fleksibilitetet ekzistuese.
- **Fokusi gjinor:** Në pajtueshmëri me Politikën e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Grave,<sup>36</sup> SBZHV do të shërbejë si një mjet për angazhimin e akterëve kyq, përfshirë QK-në, për të adresuar pabarazitë gjinore gjithandej, të cilat paraqesin pengesa të konsiderueshme në rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. Ashtu si rekomandohet nga Vlerësimi mbi Barazinë Gjinore, të Drejtat e Komunitetit LGBTI dhe të Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë,<sup>37</sup> Misioni do të vazhdojë fuqimisht të ofrojë udhëheqje të dukshme dhe mbështetje politike për avancimin e mëtejshëm të barazisë gjinore në Kosovë.
- **Fokusi rinor:** Nëse kemi parasysh profilin demografik të Kosovës, duket qartazi se të rinjtë përfaqësojnë një katalizator potencial për zhvillim shoqëror dhe ekonomik. Nëse vazhdon të jetë i marginalizuar politikisht dhe i nënpërfaqësuar ekonomikisht, ky grup shoqëror mund ta nxjerrë nga binarët rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. Pjesëmarrja më e madhe demokratike dhe ekonomike e rinisë së Kosovës është një temë transversale e tërë strategjisë së re.

## **OBJEKTIVI ZHVILLIMOR 1: Qytetarët shërbehen më mirë nga institucionet llogaridhënëse dhe efektive të qeverisjes**

*Hipoteza zhvillimore:* NËSE shoqëria civile, qytetarët dhe sektori privat shprehin fuqimisht pikëpamjet e tyre, komunikojnë nevojat e tyre, dhe i mbajnë llogaridhënëse institucionet qeveritare DHE institucionet qeveritare respektojnë dhe zbatojnë ligjet dhe rregulloret, ATËHERË pushteti politik dhe ekonomik me të cilin aktualisht janë të veshura elitat do të shpërndahet më gjerësisht ndërsa institucionet e qeverisjes në Kosovë do të jenë më llogaridhënëse para qytetarëve dhe, përfundimisht, më efektive.

Misioni i USAID-it në Kosovë planifikon të mbështesë zbatimin e plotë të ligjeve dhe rregulloreve të Kosovës duke përdorur një qasje dydrejtëshe: 1) përmes shoqërisë civile, sektorit privat dhe organizatave të bazuara në komunitete për të përfaqësuar më mirë nevojat e të gjithë qytetarëve dhe mbajtur qeverinë llogaridhënëse, dhe 2) duke përdorur ndikimin e Misionit dhe mbështetjen në ndërtimin e kapaciteteve për të ndihmuar QK-në të zbatojë më mirë ligjet dhe politikën brenda sferave të gjyqësorit, ekzekutivit dhe legjislativit, përfshirë politikën e shëndoshë fiskale dhe menaxhimin efikas të fondeve publike, qasjen gjithpërfshirëse në drejtësi me fokus tek qytetari,

<sup>36</sup> [https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1865/GenderEqualityPolicy\\_0.pdf](https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1865/GenderEqualityPolicy_0.pdf)

<sup>37</sup> [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00T8D4.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00T8D4.pdf)



ofrimin e barabartë të shërbimeve publike, dhe përfaqësimin e barabartë të të gjithë qytetarëve.

Me mbështetjen e donatorëve, Kosova ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe rregullativ i cili përgjithësisht u përmbahet standardeve të BE-së. Megjithatë, si pasojë e përkushtimit, kapacitetit dhe koordinimit joadekuat, qeveria në vazhdimësi dështon në zbatimin e plotë të këtyre ligjeve dhe rregulloreve, gjë e cila çon në pakënaqësi të qytetarëve dhe mosbesim ndaj sistemeve të qeverisjes. Përveç kësaj, fuqia politike është e koncentruar tek elitat ndërsa qytetarët e perceptojnë korrupsionin dhe favoritizmin si çështjet kryesore në vend.

*Udhërrëfyesi i Vendit*: Shikuar nëpër thjerrëzën e Udhërrëfyesit të Kosovës, ky OZH shpejton rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë duke fokusuar vëmendjen në nën-dimensionet vijuese: Nën **Përkushtim**, forcimi i pozitës së Kosovës nga aspekti i *Demokracisë Liberale* është thelbësor për rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë pasi promovon gjithpërfshirjen politike dhe paanshmërinë, si dhe mbjell kulturën e llogaridhënies gjithandej degëve të ndryshme të qeverive komunale dhe asaj qëndrore të Kosovës. Megjithëse Udhërrëfyesi nuk ka matje kuantitative për sa i përket *Qeverisë së Hapur*, Kosova renditet nën standardet rajonale nga aspekti i Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (38/45).<sup>38</sup> Megjithatë, përmirësimi i *Qeverisë së Hapur* është i rëndësishëm thelbësorë meqë qytetarët e mirëinformuar lidhur me punët e qeverisë janë më të fuqizuar për ta mbajtur qeverinë e tyre llogaridhënëse. Përmirësimi i *Barazisë së Grupeve Shoqërore dhe Hendekut Ekonomik Gjikor*, do ta avancojë në masë të madhe Kosovën drejt vetqëndrueshmërisë duke siguruar që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga arritjet e realizuara në zhvillimin e vendit.

Nën **Kapacitet**, Misioni i USAID-it në Kosovë do t'i adresojë sfidat që pengojnë *Efektivitetin e Qeverisë* së Kosovës, sidomos sa i përket zbatimit të legjislacionit ekzistues, funksionimit të institucioneve të sundimit të ligjit në vend dhe ofrimit të shërbimeve publike komunale. Njëkohësisht me zbatimin e këtij OZH, Misioni i USAID-it në Kosovë do t'i shfrytëzojë anët e forta të Kapacitetit, siç është *Efektiviteti i Shoqërisë Civile*, për të avancuar mbikëqyrjen publike duke u mundësuar të gjithë qytetarëve të vendosin mbi dhe kontribuojnë për prioritetet zhvillimore të Kosovës. Përdorimi i TIK-ut – një forcë e nënshfrytëzuar, meqë Kosova është një nga vendet më së miri të lidhura me internet në Europë – është një dimension të cilin Misioni i USAID-it në Kosovë planifikon ta eksplorojë më thellësisht.

*Përshtatja me Prioritetet e Qeverisë së Kosovës*: Ky OZH përshtatet mirë me prioritetet e QK-së të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)<sup>39</sup> dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, ku të dy dokumentet i japin prioritet qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe integritetit në BE. Të dy dokumentet kërkojnë: rritje të transparencës dhe zvogëlim të korrupsionit, zvogëlim të barrës administrative, sigurim

<sup>38</sup> <https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/democracy-human-rights-and-governance>

<sup>39</sup> [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National\\_Development\\_Strategy\\_2016-2021\\_ENG.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf)

të të drejtave pronësore dhe zvogëlim të ekonomisë joformale. Në fushat e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, SKZH parasheh avancimin e ofrimit të shërbimeve me fokus tek klienti për bizneset dhe publikun, inkurajimin e hartimit të politikave të bazuara në dëshmi, mbylljen e boshllëqeve në sistemin e prokurimit publik, forcimin e sistemit të të drejtave pronësore, dhe rritjen e efikasitetit gjyqësor. Misioni ka besim të plotë në përkushtimin e QK-së për t'i zvogëluar në numër por edhe thjeshtuar dhe racionalizuar rregullat dhe procedurat që shpesh paraqesin pengesa. Për herë të parë po mbahen një sërë konsultimesh publike me biznese, shoqata, shoqërinë civile, media, donatorë dhe institucione publike për të informuar hartimin dhe zbatimin e Planit për Përmirësimin e Integritetit të Administratës Tatimore të Kosovës. Përveç kësaj, SBZHV-ja e re është gjithashtu në të njëjtën linjë me Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, e cila kërkon një pjesëmarrje më të madhe të shoqërisë civile në hartimin e politikave.<sup>40</sup> Misioni i USAID-it në Kosovë nuk lëshon rastin të shfrytëzojë mundësi të tilla për t'u bërë një lloj indi lidhës që ndihmon Kosovën – qeverinë dhe popullin e saj – të lëvizin drejt vetqëndrueshmërisë.

*Si i kontribuojnë Rezultatet e Ndërmjetme OZH-së:* Që të dy Rezultatet e Ndërmjetme (RN) nën OZH1 i përmbahen qasjes së dyfishtë të fokusimit në të dyja anët, si atë të ofertës ashtu edhe të kërkesës, të qeverisjes së mirë. Duke ndërtuar mbi marrëdhëniet e tij produktive me QK-në dhe partneritetet me shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit, Misioni i USAID-it në Kosovë do të mbështesë një demokraci më llogaridhënëse, gjithpërfshirëse dhe të përgjegjshme.

Llogaridhënia nënkupton zbatimin e ligjit jo vetëm kur një gjë e tillë është e përshtatshme apo e lehtë, por në vazhdimësi e me konsistencë, brenda afateve të duhura kohore. Kjo kërkon një qasje edhe më rigoroze ndaj adresimit të korrupsionit dhe joefikasitetit në qeveri. Fuqizimi i qytetarëve për të pritur dhe kërkuar që zyrtarët e tyre qeveritar, si në nivelin nacional ashtu edhe atë lokal, të jenë menaxhues më të mirë të burimeve qeveritare, do të krijojë një shërbim qeveritar më llogaridhënës dhe efektiv për të gjithë qytetarët.

*Parasupozimet:*

- Do të ketë jostabilitet politik të ulët gjatë kohëzgjatjes së strategjisë.

*Faktorët e riskut:*

Në të kaluarën, një suksesion qeverish afatshkurtëra të koalicionit rezultoi me kufizim të mundësive për të hartuar dhe zbatuar politika, përplasje të brendshme dhe mungesë koordinimi në mes ministrive, dhe ndërprerje të vazhdimësisë së nismave zhvillimore të Kosovës. Ekziston risku që një jostabilitet i ngjashëm politik mund të ketë ndikim të fuqishëm në realizimin e rezultateve në kuadër të OZH.

---

<sup>40</sup> [http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy\\_eng\\_291507.pdf](http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_eng_291507.pdf)

## **Rezultati i Ndërmjetëm 1.1: Forcohet përgjegjshmëria e institucioneve të drejtësisë**

*Si i kontribuon RN OZH-së:* Nëse komunitetet, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, janë të lidhura më mirë me institucionet e drejtësisë, dhe nëse institucionet në fjalë zbatojnë në mënyrë konsistente politikat dhe procedurat që e bëjnë drejtësinë më transparente dhe të qasshme për anëtarët e komunitetit, atëherë përgjegjshmëria dhe cilësia e institucioneve të drejtësisë ndaj qytetarëve të cilëve u shërbejnë do të përmirësohet.

Përkundër arritjeve të rëndësishme të Kosovës viteve të fundit, mungon besimi i publikut në sistemin e drejtësisë. Pikëarritjet e rëndësishme përfshijnë integrimin e pjesës veriore në sistemin e drejtësisë në vitin 2017, zvogëlimin dramatik të lëndëve gjyqësore të prapambetura dhe miratimin e tetë ligjeve madhore për të forcuar sundimin e ligjit si dhe avancuar eficientë dhe transparencën e tij. Megjithatë, këto arritje ende nuk kanë ndikuar në masë të ndjeshme në perceptimin nga ana e publikut të institucioneve gjyqësore dhe vazhdon të ekzistojë një mungesë e përgjithshme e vetëdijës mbi përparimin e arritur në planin e përpjekjeve reformuese. Përveç kësaj, mbeten edhe sfidat praktike: aktgjykimet jokonsistente dhe “efekti ping-pong i gjykatave,” me lëndë që lëvizin nga gjykata në gjykatë ndërsa asnjëra nga to nuk merr mbi vete përgjegjësinë për juridiksionin përfundimtar, kërkesat procedurale të stërzgjatura si dhe barrierat gjuhësore dhe pengesat tjera që pengojnë përfshirjen efektive të të gjitha komuniteteve.

Për të adresuar mosbesimin publik dhe sfidat që vazhdojnë të jenë prezente brenda sistemit të gjyqësorit, misioni i USAID-it në Kosovë do të punojë me gjykatat, zyrat për ndihmë juridike, dhe ofruesit tjerë alternativ të drejtësisë si dhe komunitetet të cilave ata u shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e përvojës së drejtësisë për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe akterët nga sektori privat. Së dyti, misioni i USAID-it në Kosovë do të përmirësojë cilësinë dhe qasshmërinë e shërbimeve të drejtësisë për të gjithë, me një fokus në performancën e gjykatave dhe zyrave për ndihmë juridike në ofrimin e shërbimeve. Përfundimisht, misioni i USAID-it në Kosovë do të punojë me institucionet e gjyqësorit për të zbatuar reforma të përqëndruara tek njerëzit, thënë në mënyrë të përgjithësuar – të tilla si rritja e disponueshmërisë së ndihmës juridike, rritja e aftësisë për të ushtruar të drejta pronësore, rritja e përdorimit të mekanizmave alternativ të zgjidhjes së kontesteve dhe zhvillimi i zgjidhjeve inovative për t’iu përgjigjur nevojave juridike të papërbushura.

Në anën e kërkesës përgjatë spektrit, misioni i USAID-it në Kosovë do të sigurojë një angazhim aktiv të shoqërisë civile, mediave të pavarura dhe sektorit privat për të realizuar një mbikëqyrje efektive dhe për tu përfshirë aktivisht në çështjet e gjyqësorit.

*Lidhja me Politikën e Qeverisë së Kosovës:* Misioni i USAID-it në Kosovë do të vazhdojë të mbështesë zbatimin e politikave të QK-së që rrisin besimin publik në sistemin e drejtësisë. Përveç kësaj, USAID-i do të vazhdojë të mbështesë procesin e QK-së të

Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, në koordinim me agjencitë tjera të QSHBA dhe donatorët ndërkombëtar. Ky Rishikim i QK-së përfshin një proces gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës të udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë (MD) i cili do të prodhojë Strategjinë e parë të Vendit për Sundim të Ligjit në Kosovë. Mirëpo, ndërhyrjet e USAID-it në kuadër të RN 1.1 do të zhvendosin fokusin e reformës dhe ndihmës nga një qasje më e përqëndruar në ndërtim dhe forcim të institucioneve tek një qasje e përqëndruar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve kundrejt nevojave të njerëzve për drejtësi përmes shërbimeve më cilësore dhe më të qasshme.

*Akterët vendor:* RN 1.1 përfshin pjesëmarrjen e nivelit lokal dhe atij qendror të sistemit të gjyqësorit, opinion-krijuesve dhe strukturave të mbikëqyrjes qytetare. Shoqëria civile, sektori privat, institucionet hulumtuese, “think-tank”-et dhe universitetet, do të angazhohen si udhëzues për të mbështetur angazhimin e shtuar të qytetarëve.

*Partneritetet inovative:* Misioni i USAID-it në Kosovë do të vazhdojë të zhvillojë partneritete të reja që ndihmojnë avancimin e RN 1.1 dhe rrugëtimin drejt vetqëndrueshmërisë me akterët vijues qeveritar dhe privat: MD-në dhe ministritë tjera të linjës, Kuvendin e Kosovës, qeveritë komunale, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe gjykatat. Misioni gjithashtu synon të zgjerojë mbështetjen e tij të OSHC-ve vendore, të cilat janë dëshmuar si efektive në avancimin e zbatimit të ligjeve dhe politikave.

*Baza e fakteve:* Puls i Publik i UNDP-së, Analiza e QK-së e Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, Vlerësimi mbi Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisjen (DRG) 2017, Analiza e Ekonomisë Politike e Kosovës 2017, Raporti i Vlerësimit të Shpejtë të Konfliktëve për Kosovën, Vlerësimi Afatmesëm i Programit të të Drejtave Pronësore, Vlerësimi Afatmesëm i Programit të Forcimit të Sektorit të Drejtësisë, dhe Vlerësimi i Shpejtë i Pronave në Kosovë.

## **Rezultati i Ndërmjetëm 1.2: Forcohet qeverisja ekzekutive dhe përgjegjshmëria ligjvënëse**

*Si i kontribuon RN OZH-së:* Nëse qytetarët mbajnë degën ekzekutive të Kosovës dhe institucionet llogaridhënëse për ofrim të shërbimeve, dhe nëse partitë politike janë më llogaridhënëse ndaj zgjedhësve të tyre, atëherë strukturat qeveritare në të gjitha nivelet brenda Kosovës do të përmbushin më me efektivitet nevojat e qytetarëve.

Megjithëse Kosovo ka një kuadër ligjor të etabluar, ka ngecje sa i përket përkushtimit të plotë për t'i zbatuar politikat ekzistuese. Përmes RN 1.2, Misioni i USAID-it në Kosovë do t'i japë shtytje llogaridhënies nga ana e QK-së, duke mbështetur OSHC-të dhe mediat e pavarura në monitorimin e zbatimit të politikave qeveritare, promovuar udhëheqje më të fortë të partive politike, punuar me komunat në parandalimin e korrupsionit, dhe mbështetur institucione të ndryshme të degës ekzekutive dhe ligjvënëse në përmbushjen e mandateve të tyre.

Nga aspekti i VF (Vetqëndrueshmërisë Financuese), Misioni i USAID-it në Kosovë do të mbështesë, në kuadër të RN 1.2, përmirësimin e kapaciteteve dhe performancës së institucioneve të ndryshme ligjvënëse dhe ekzekutive për të siguruar sisteme që janë më efçente, të paanëshme dhe të parashikueshme, në konsultim me qytetarët. Më konkretisht, Misioni do të vazhdojë angazhimin me Administratën Tatimore të Kosovës për të siguruar një sistem të qëndrueshëm të resurseve vendore (MRV) i cili është efçent. Misioni do të mbështesë përmirësimin e praktikave të menaxhimit të financave publike (MFP) dhe kapaciteteve teknike për parashikimin e buxhetit, forcimin e sistemeve për ekzekutim të buxhetit dhe sigurimin e disiplinës fiskale. Misioni do të vazhdojë të mbështesë programimin nën shtyllën e transparencës dhe llogaridhënies fiskale (TLLF) për të siguruar se fondet publike alokohen dhe shpenzohen në mënyrë transparente, efektive dhe gjithpërfshirëse. Përfundimisht, për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për rritje të investimeve private (MPIP), Misioni do të mbështesë të drejtat pronësore, politikat e konkurrencës gjithpërfshirëse, sundimin e fortë të ligjit dhe transparencën e zbatimit të kontratave.

*Lidhja me Politikën e Qeverisë së Kosovës:* RN 1.2 është në të njëjtën linjë me Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023, e cila kërkon një pjesëmarrje të rritur të shoqërisë civile në hartimin e politikave.<sup>41</sup> Ai është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Prokurimit Publik 2017-2021, e cila përqendrohet në menaxhimin më efektiv dhe transparent të fondeve publike, dhe me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë, e cila parasheh një qasje më të drejtë dhe të paanëshme ndaj posedimit të pronës. Në anën ekonomike, RN 1.2 është në përputhje me objektivin e QK-së për stabilitet makro-financiar dhe disiplinë fiskale.

*Akterët vendor dhe ata relevant rajonal:* USAID-i do të angazhojë akterët kyq brenda strukturës ekzekutive dhe asaj ligjvënëse, sektorit privat, shoqërisë civile dhe diasporës.

*Partneritetet inovative:* Misioni i USAID-it në Kosovë do t'i vazhdojë marrëdhëniet ekzistuese dhe do të eksplorojë rrugë të reja për partneritete inovative me MD-në; Ministrinë e Financave dhe Transfereve (MFT), Ministrinë e Infrastrukturës dhe Mjedisit, Ministrinë e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Administratën Tatimore të Kosovës, Zyrën për Qeverisje të Mirë, komunat e zgjedhura, odat e zgjedhura të afarizmit dhe tregtisë, si dhe agjencitë e pavarura, përfshirë Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe Agjencinë kundër Korrupsionit.

*Baza e fakteve:* Përmirësimi i Administratës Tatimore i FMN-së, Raporti "Të Bërit Biznes" i Bankës Botërore, Vlerësimi mbi Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisjen (DRG), Analiza e Ekonomisë Politike e Kosovës, dhe Puls i UNDP-së.

---

<sup>41</sup> [http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy\\_eng\\_291507.pdf](http://www.civikos.net/repository/docs/Strategy_eng_291507.pdf)



## **OBJEKTIVI ZHVILLIMOR 2: Rriten mundësitë për pjesëmarrje gjithpërfshirëse demokratike dhe ekonomike**

*Hipoteza zhvillimore:* NËSE bëhen të disponueshme rrugët për angazhim demokratik dhe ekonomik përmes 1) bashkëpunimit të qëndrueshëm në mes të qytetarëve, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat DHE përmes 2) një sektori privat konkurent që përfshin furnizim të sigurtë me energji elektrike dhe investime në fuqinë punëtore të Kosovës që janë të orientuara drejt tregut, ATËHERË do të ketë mundësi më të mëdha për qytetarët, veçanërisht të rinjtë dhe gratë, të marrin pjesë në jetën qytetare dhe ekonomike dhe t'u kontribuojnë atyre.

Misioni e sheh bashkëpunimin e qëndrueshëm në mes të qytetarëve, institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat si një përbërës të pazëvendësueshëm i cili e avancon Kosovën në rrugëtimin e saj drejt vetqëndrueshmërisë. Organizimi nga ana e qytetarëve të Kosovës rreth interesave të tyre dhe veprimi kundrejt vendimeve të cilat ndikojnë në jetërat e tyre janë indi që e mban këtë hipotezë zhvillimore si një tërësi. Ky Objektiv Zhvillimor do t'u zgjërojë mundësitë për angazhim aktiv, të orientuar drejt rezultateve, zërave më pak të dëgjuar, përkundër rëndësisë së tyre, veçanërisht të rinjve, grave, minoriteteve dhe sektorit privat. Fokusimi në këto grupe avancon mobilizimin politik të të rinjve, grave dhe minoriteteve, kapitalin njerëzor dhe shkathtësitë e fuqisë punëtore tek të rinjtë, shkallën e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore aktive, si dhe konkurrencën e sektorit privat.

Mundësia apo shansi në kontekstin kosovar nuk është diçka thjesht e natyrës ekonomike. Situatat që janë rrjedhojë e status kuosë së rrënjësor mund të sfidohen në mënyrën më të suksesshme duke sjellur në qendër të vëmendjes zëra të pavarur dhe më pak të dëgjuar – gratë, të rinjtë, minoritetet, grupet e marginalizuara, dhe sektorin privat. Konvergimi i interesave të ngushta politike dhe ekonomike të elitave të Kosovës mban peng përparimin dhe rrënon llogaridhënien, si në sferën demokratike ashtu edhe atë ekonomike. Mundësitë për pjesëmarrje, angazhim dhe avokim mund të jenë penda zhvillimore e cila ndalon bashkërrjedhjen e mëtejme të interesave të tillë.

Nevoja për të zgjeruar mundësitë demokratike dhe ekonomike në Kosovë buron nga faktorët vijues. Së pari, një gjeneratë e re, relativisht e madhe për nga numri, e të rinjve të Kosovës po arrin moshën madhore e me të edhe të drejtën për të votuar – dy shtytës të fuqishëm të zhvillimit politik dhe ekonomik. Mungesa e mundësive ekonomike, mbisundimi i korrupsionit dhe pandëshkueshmëria e elitave, krahas mungesës së mekanizmave për përfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse, po e parandalojnë Kosovën në realizimin e potencialit të plotë të pjesës më të madhe të popullatës së saj – rinisë.

Së dyti, niveli i pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore aktive është shkurajues. Me gjithë faktin se ekzistojnë një sërë çështjesh që i kontribuojnë këtij realiteti dëshprues, Misioni beson se gratë duhet të kenë hapësirën e tyre demokratike për të kontrolluar të

ardhmen e tyre përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me shoqërinë civile dhe sektorin privat, e rrjedhimisht edhe të ndikojnë në reformimin e qeverisë.

Së treti, për shkak të sistemeve të ndara të arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve tjera sociale, mundësitë për përvoja të përbashkëta midis grupeve etnike nuk paraqiten në mënyrë spontane. Minoritetet, përfshirë ato etnike, gratë dhe personat “jo-cisgender” (*me orientim gjinor të ndryshëm nga gjinia e tyre e lindjes*), përballen me jetë politike të kufizuar, përfshirë kufizimet nga aspekti i lirisë së fjalës dhe qasjes në shërbime qeveritare. Mundësitë demokratike janë thelbësore për minoritetet në Kosovë, në mënyrë që ato të mund t’i ndjekin aktivisht mundësitë ekonomike dhe të ndjehen se janë pjesë e mirfilltë e strukturës së shoqërisë së Kosovës.

Përfundimisht, konkurueshmëria e sektorit privat është shtysë për rritjen e Kosovës. Aktualisht, sektori publik vazhdon të jetë punëdhënësi parësor në Kosovë. Brenda ekonomisë formale, sektori publik siguron pjesën më të madhe të vendeve të punës (54 përqind), i ndjekur nga ndërmarrjet e mëdha në sektorin privat ku janë të punësuar 41 përqind e punonjësve.<sup>42</sup> Pagat dhe beneficionet në sektorin publik i tejkalojnë ato të sektorit privat. Nepotizmi është një nga format më të rrënjësura të korrupsionit – aspak recetë për vetqëndrueshmëri.

*Udhërrëfyesi i Vendit.* Udhërrëfyesi thekson nivelin nën mesatar të *Barazisë së Grupeve Shoqërore* në Kosovë ndërsa burimet e jashtme pasqyrojnë një realitet të rëndë sa i përket *Hendekut Ekonomik Gjinor* të Kosovës. Ngritja e pritshmërive për të dy treguesit e mësipërm ka rëndësi thelbësore për avancimin e mëtejshëm të Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. Përderisa *Cilësia e Arsimit* e tregon Kosovën të jetë mbi mesataren e VAUM, nga këdvështrimi i Misionit pamja është e zyrtë dhe dekurajuese bazuar edhe në rezultatin e arritur në Programin e Vlerësimit Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) 2018,<sup>43</sup> ku Kosova u rangua e treta nga fundi i listës së 80 vendeve.

Përkushtimi dhe angazhimi i përmirësuar i vetë qytetarëve të Kosovës do të shtyjë përpara axhendën e Misionit me forcimin e anës së Kapacitetit të Udhërrëfyesit: *Efektivitetit të Qeverisë, Diversifikimit të Eksportit, dhe BPV-së për kokë banori*, ku Kosova rangohet 42/45 në nivel rajoni.<sup>44</sup>

Përkundër shenjave të përparimit, sfidat e Kosovës nga aspekti i strukturës së ekonomisë së saj mbeten të konsiderueshme: shkalla e lartë e papunësisë dhe e joaktivitetit, informaliteti ekonomik gjërësisht i përhapur, mbështetja në masë të madhe në remitenca, dhe deficitin e madh tregtar e ulin treguesin e *BPV-së për kokë banori* – megjithë faktin se Udhërrëfyesi e pasqyron atë mbi mesataren e VAUM. Mobilizimi i duhur i resurseve dhe mbyllja e hendekut të vazhdueshëm të shkathësive në mes të

<sup>42</sup> BB: Diagnoza e vendeve të punës, 2017 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore, f.44: <http://documents.worldbank.org/curated/en/814361497466817941/pdf/ACS21442-WP-PUBLIC-ADD-SERIES-KosovoJDWEB.pdf>

<sup>43</sup> PISA 2018, Kosova: [https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018\\_CN\\_KSV.pdf](https://www.oecd.org/pisa/publications/PISA2018_CN_KSV.pdf)

<sup>44</sup> <https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/economy/economic-growth>

përgatitjes së fuqisë punëtore dhe nevojave reale të sektorit privat do të rezultojë me zhvillim të qëndrueshëm.

Të dhënat alternative nga Tregtia e Jashtme e Kosovës ilustrojnë një deficit më të lartë në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak 2017, për 2.1 përqind. Fokusimi në *Sofistikim të Eksportit* është një mundësi për ta bërë sektorin privat më fleksibil, si dhe për të tërhequr diasporën dhe IHD, që nga ana e tyre do t'i kontribuonin një ekonomie të vetqëndrueshme dhe më fleksibile.

Megjithëse siguria energjetike nuk është e përfshirë në Udhërrëfyes, fakti se furnizimi i pasigurtë me energji elektrike u kushton bizneseve të Kosovës afërsisht 400 milion dollarë amerikan çdo vit<sup>45</sup> është një sinjal rrugor brengosës për gjatë rrugëtimit të Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë.

*Përshatja me Prioritetet e Qeverisë së Kosovës: OZH2* përputhet ngushtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të Kosovës, mbi shtyllat e Kapitalit Njerëzor, Infrastrukturës Energjetike dhe Konkureshmërisë së Sektorit Privat; megjithëse për QK-në shtylla e kapitalit njerëzor nënkupton vetëm angazhimin ekonomik, ndërsa për misionin e USAID-it në Kosovë kapitali njerëzor bart me vete edhe aftësinë e qytetarëve për t'u angazhuar në sisteme politike dhe demokratike duke ndikuar kështu në të ardhmen e tyre.

Disa nga veprimet e programuara nën SKZH të Kosovës kanë për synim zhvillimin e një sektori privat konkurent përmes mbështetjes së NVM-ve, zvogëlimit të ekonomisë informale dhe rritjes së IHD-ve duke zhvilluar kapitalin njerëzor dhe përmirësuar sigurinë energjetike. Misioni i USAID-it në Kosovë mezi pret të shohë rezultatet e një përkushtimi më të fortë të Qeverisë së Kosovës ndaj realizimit të veprimeve të lartpërmendura.

*Si i kontribuojnë Rezultatet e Ndërmjetme këtij OZH: Përderisa* strategjia paraprake përqëndrohej në forcimin e sektorit privat me qëllim që ai të krijonte vende pune si dhe në çimentimin e bazamentit ligjor dhe institucional për një ekonomi të tregut, kësaj radhe Misioni ka për qëllim të angazhojë asetet më të madh që ka Kosova: njerëzit e saj. Për të bërë këtë, Misioni do të bashkëpunojë më ngushtë me sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët marrë përgjithësisht, në identifikimin dhe tejkalimin e pengesave ndaj zhvillimit të Kosovës.

Për të mbështetur krijimin e mundësive më të mëdha demokratike dhe ekonomike për qytetarët e Kosovës, veçanërisht gratë dhe të rinjtë, qasja e misionit të USAID-it në Kosovë është e ndarë në dy shtylla: 1) të mbështesë nismat e drejtuara nga qytetarët dhe bashkëpunimin në mes shoqërisë civile, qeverisë dhe sektorit privat për angazhim më të mirë dhe krijim të mundësive për të gjithë qytetarët, veçanërisht të rinjtë, dhe 2) të krijojë një ekonomi të cilës ofron mundësi përmes rritjes së konkureshmërisë së sektorit

---

<sup>45</sup> Analiza e MCC e Pengesave në Kosovë citon studimin e USAID-it: <https://assets.mcc.gov/content/uploads/Constraints-Analysis-Kosovo-1.pdf>

privat, përmirësimit të sigurisë energjetike dhe një fuqie punëtore të aftë. Kjo qasje dydrejtmëshe qëndron mbi tri rezultate të ndërmjetme: a) rritjen e kontributit të qytetarëve demokracisë dhe ekonomisë, b) rritjen e konkureshmërisë së sektorit privat në sektorët e shënjestruar, dhe c) përmirësimin e sigurisë energjetike.

*Fokusi gjinor.* OZH2 do të fokusohet në përpjekjet për të mbyllur hendekun gjinor nga aspekti i pjesëmarrjes qytetare dhe demokratike, barazisë së të ardhurave, pjesëmarrjes në fuqinë punëtore aktive dhe qasjes në kapital prodhues, si toka dhe kreditë. Pas rekomandimeve të Analizës Gjinore për Kosovën,<sup>46</sup> Misioni do të punojë me përkushtim në rritjen e ndërgjegjësimit mbi vlerën e pjesëmarrjes së grave në proceset demokratike dhe ekonomike, të arsyetojë nga aspekti biznesor nevojën për të përfshirë më shumë gra në sektorin energjetik, të angazhojë më shumë gra në nivelin komunal, dhe të konsultohet në mënyrë më aktive me gratë, ekspertët e barazisë gjinore dhe organizatat e të drejtave të grave gjatë dizajnit të projekteve dhe aktiviteteve.

*Parasupozimet:*

- Do të ketë jostabilitet politik të ulët gjatë kohëzgjatjes së kësaj strategjie
- Do të ketë stabilitet makro-ekonomik në Kosovë dhe rajon

*Risqet:*

- Integrimi i sektorëve energjetik të Kosovës dhe Shqipërisë varet nga stabiliteti politik në të dy vendet për të zbatuar ndryshimet kyqë të politikave.
- QK mund të rrisë ose ulë tarifën e energjisë elektrike për qëllime politike.
- Mungesa e mundësive për angazhim domethënës të të rinjve mund të përkeqësojë situatën dhe të rrisë migrimin e të rinjve dhe sjelljet negative në mesin e tyre.
- Qeveritë afatshkurtra të koalicionit mund të rezultojnë me mundësi minimale për të hartuar dhe zbatuar politika.

## **Rezultati i Ndërmjetëm 2.1: Rritet kontributi i qytetarëve ndaj demokracisë dhe ekonomisë**

*Si i kontribuon RN OZH-së:* Është fakt tashmë i etabluar se kur qytetarët janë të mirëinformuar dhe marrin pjesë aktivisht në demokraci dhe ekonomi, vendet prosperojnë si ekonomikisht ashtu edhe nga aspekti shoqëror. Duke angazhuar në mënyrë aktive të gjithë qytetarët, veçanërisht të rinjtë, Kosova ka një potencial të jashtëzakonshëm për të realizuar dividenda më të mëdha demokratike dhe ekonomike.

---

<sup>46</sup> Vlerësimi Gjinor-LGBTI-Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, prill 2018: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00T8D4.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00T8D4.pdf)

RN 2.1 fokusohet në organizimin nga ana e qytetarëve të Kosovës rreth interesave të tyre dhe ndërmarrjen e veprimeve për t'i kontribuar vendimmarrjes e cila ndikon në jetërat e tyre, por kjo nuk ka të bëjë vetëm me mbikëqyrjen e qeverisë dhe zbatimin e politikave publike. Shembujt përfshijnë, duke mos u kufizuar vetëm në: ndihmesën dhëne OSHC-ve vendore për të bashkëpunuar më mirë me donatorë vendor qoftë korporativ apo individual, angazhimin e pjestarëve të diasporës në nisma zhvillimore, promovimin e nismave për përmirësim që përshtatshëm vijat ndarëse të komuniteteve dhe tejkalojnë kufinj të një komune të vetme, dhe nxitjen e rritjes së llogaridhënies së OSHC-ve vendore si ndaj përfituesve të tyre ashtu edhe ndaj mbështetësve vendor.

RN 2.1 gjithashtu do t'u zgjerojë mundësitë për pjesëmarrje ekonomike veçanërisht qytetarëve të rinj të Kosovës, duke i kontribuar në këtë mënyrë një rritjeje më gjithëpërfshirëse dhe me bazë të gjerë të ekonomisë së vendit. Megjithatë ky RN përfshin të gjithë qytetarët pa dallim, misioni i USAID-it në Kosovë qëllimisht përqëndrohet tek të rinjtë. Përkundër faktit se përfaqësojnë mbi 50 përqind të popullsisë së Kosovës, të rinjtë përballen me pengesa të shumfishta nga aspekti i pjesëmarrjes së tyre demokratike dhe ekonomike dhe jo rrallë konsiderohen si një detyrim dhe barrë qoftë nga sektori publik apo ai privat. Njëkohësisht, institucionet arsimore nuk i përgatisin si duhet të diplomuarit me shkathtësitë që i duhen sektorit privat. Përmes këtij RN, misioni i USAID-it në Kosovë synon të ndryshojë këtë perceptim në mënyrë që të rinjtë të shihen si një aset, ndërsa ata vetë të fitojnë vetebesimin për t'i vënë zërat dhe shkathtësitë e tyre në shërbim të zhvillimit të Kosovës. Duke patur vazhdimisht parasysh lidhshmërinë e ngushtë në mes progresit ekonomik dhe atij demokratik, RN 2.1 synon të zvogëlojë papunësinë tek të rinjtë duke avancuar përshtatjen e shkathtësive që ata fitojnë me nevojat e tregut të punës dhe duke ndihmuar në krijimin e hapësirës që do t'u mundësojë të rinjve të jenë pjesëmarrës aktiv në procese demokratike dhe t'i kontribuojnë kohezionit shoqëror.

RN 2.1 do t'i fuqizojë gratë dhe të rinjtë si demokratikisht ashtu edhe ekonomikisht. Papunësia e të rinjve është afër 60 përqind, ndërsa vetëm 25 përqind<sup>47</sup> e grave janë pjesë e fuqisë punëtore formale. Mospërfshirja e një pjese kaq të madhe të popullsisë në aktivitetin ekonomik formal paraqet një ngarkesë të rëndë fiskale dhe pengesë madhore ndaj rritjes së konkurrencës ekonomike të Kosovës. Prandaj, gjatë dizajnit dhe zbatimit të programeve të tij nën këtë RN, Misioni do të përqëndrohet në mundësitë për rritjen e pjesëmarrjes ekonomike të grave të reja në veçanti.

*Lidhja me Politikën e Qeverisë së Kosovës:* Një nga prioritetet kryesore të QK-së është investimi në kapitalin njerëzor në formë të rritjes së cilësisë së arsimimit, punësimit dhe kujdesit shëndetësor me qëllim të përshtatshëm të zhvillimit ekonomik. Këto prioritete janë artikuluar në nivelin më të lartë në SKZH 2016-2021 të Kosovës. Sa u përket çështjeve të veçanta, ky RN është në të njëjtën linjë me Strategjinë Qeveritare për

---

<sup>47</sup> Analiza e MCC e Pengesave në Kosovë: <https://assets.mcc.gov/content/uploads/Constraints-Analysis-Kosovo-1.pdf>



Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023,<sup>48</sup> Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (2017-2021)<sup>49</sup> dhe Strategjinë për Rininë (2019-2023).<sup>50</sup>

*Akterët vendor:* Grupet Formale dhe Joformale të të Rinjve dhe Grave; Komunitetet Minoritare; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike; drejtoritë komunale të arsimit; ndërmarrjet private në komuna të zgjedhura; shoqatat e sektorit; dhe Zyra për Qeverisje të Mirë.

*Partneritetet inovative:* Misioni i USAID-it në Kosovë do të ndërlidhet me palët e interesuara të qeverisë, sektorin privat, OSHC-të, diasporën e Kosovës dhe donatorët tjerë që janë të interesuar të zgjerojnë mundësitë demokratike dhe ekonomike për qytetarët e Kosovës.

*Baza e fakteve:* Programi i Leadershipit Transformues – Vlerësimi i Ndikimit dhe Performancës, Raporti i Vendit për Kosovën (2019) i Bankës Botërore, Raporti i Progresit të Vendit i BE-së (2019), Vlerësimi i Nevojave për Shkathtësi i UNDP-së, Pulsi Publik i UNDP-së, Vlerësimi mbi Demokracinë, të Drejtat e Njeriut dhe Qeverisjen (DRG), dhe Indeksi i Qëndrueshmërisë së Shoqërisë Civile 2018.

## **Rezultati i Ndërmjetëm 2.2: Rritet konkurrueshmëria e sektorit privat në sektorët e shënjestruar**

*Si i kontribuon RN OZH-së:* Promovimi i angazhimit të sektorit privat është një element kyq i rrugëtimit të Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. USAID-i planifikon ta angazhojë sektorin privat si partner dhe katalizator për zhvillimin e Kosovës. Me rritjen e tyre dhe gjenerimin e fitimeve më të mëdha, bizneset vendore bëhen më të afta për të planifikuar, financuar dhe implementuar zgjidhje të cilat i kontribuojnë zhvillimit të Kosovës, duke zvogëluar në këtë mënyrë nevojën për ndihmë nga jashtë.

Studimet tregojnë se joaktiviteti ekonomik deprimon angazhimin politik. Pjesëmarrja politike rritet me rritjen e nivelit të arsimit, të ardhurave dhe statusit profesional. Suksesi i demokracive mund të gjykohej edhe përnga barazia e pjesëmarrjes ekonomike të të gjitha grupeve shoqërore. Për më tepër, gjithnjë e më shumë hulumtime ndërkombëtare po identifikojnë pamjaftueshmërinë e pjesëmarrjes femërore në fuqinë punëtore (PFFP) dhe ndërmarrësisë femërore si një faktor kufizues ndaj rritjes ekonomike dhe shkakton i të ardhurave të ulëta për kokë banori. Rrjedhimisht, angazhimi aktiv demokratik dhe mundësitë adekuate ekonomike shkojnë krah për krah.

Si përgjigje, misioni i USAID-it në Kosovë ka identifikuar rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat si pjesë të zgjidhjes për rrugëtimin e Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. RN 2.2 do të realizohet përmes tri qasjeve kryesore: 1) lidhjeve të forcuara të tregut, 2)

<sup>48</sup> [http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/02/Strategy\\_eng.pdf](http://ojqfinancime.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/02/Strategy_eng.pdf)

<sup>49</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-kesp-2017-2021-1.pdf>

<sup>50</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit: [https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategy\\_for\\_Youth\\_2019-2023.pdf](https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Youth_2019-2023.pdf)

cilësisë dhe sasisë së rritur të mallrave dhe shërbimeve për të cilat ka kërkesë të lartë, dhe 3) mjedisit të përmirësuar për investime private.

Për të patur qasje në mundësitë e tregut, bizneset duhet të përmirësojnë cilësinë dhe sasinë e mallrave dhe shërbimeve, gjë të cilën mund ta arrijnë në mënyrë të qëndrueshme përmes shfrytëzimit të ofruesve lokal dhe shërbimeve të zhvillimit të biznesit, si dhe partnerëve tjerë. Misioni i USAID-it në Kosovë do të promovojë lidhje në mes të sektorit privat dhe tregjeve të reja, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Së dyti, Misioni do të identifikojë shoqatat e industrisë dhe/ose akterët ekzistues dhe tërësisht të ri në sektorët e shënjestruar me potencial të lartë të rritjes që mbështesin cilësinë dhe sasinë e shtuar të mallrave dhe shërbimeve.

Përfundimisht, misioni i USAID-it në Kosovë do t'i japë shtytje dialogut produktiv në mes të sektorit privat dhe qeverisë, për të arritur efekt më të madh në krijimin e një mjedisi afarist të përshtatshëm për tërheqje të investimeve, vendore dhe të huaja. Misioni do ta ndihmojë QK-në të krijojë një mjedis më tërheqës për konkurrueshmërinë e sektorit privat, jo vetëm përmes punës së drejtpërdrejt me strukturat qeveritare të shënjestruara, por edhe duke angazhuar Korporatën e re të Financimit të Zhvillimit (DFC) e cila e ka ranguar Kosovën si një vend të Nivelit 1 duke i dhënë përparësinë më të lartë. USAID-i do të bashkëpunojë ngushtë me Departamentin e Shtetit dhe udhëheqjen e DFC-së për të krijuar një "tubacion" (*pipeline*) të mundësive investuese në bashkëpunim me sektorin privat vendor dhe QK-në. USAID-i gjithashtu do të përfshijë edhe zëra të tillë si diasporën, shoqatat e biznesit dhe strukturat tjera joqeveritare që kanë interes nga një sektor privat i gjallërisht në Kosovë (*Kapaciteti: Efektiviteti i Qeverisë*). Misioni i USAID-it në Kosovë është në pozitë të mirë për ta udhëzuar QK-në këtë rrugëtim sepse ai tashmë ka partneritete të etabluara me strukturat brenda qeverisë, të tilla si Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave dhe Transfereve, për të ngritur një platformë e cila tërheq investime vendore dhe IHD.

RN 2.2 do ta shohë sektorin privat si një partner i cili ofron zgjidhje kreative për ndërtimin e lidhjeve të tregut dhe rritjen e sasisë dhe cilësisë së mallrave dhe shërbimeve për të cilat ka kërkesë të lartë (*Kapaciteti: Sofistikimi i Eksportit*).

*Lidhja me Politikën e Qeverisë së Kosovës:* Ky RN është në të njëjtën linjë me prioritetet e QK-së, përkatësisht me rritjen e përshpejtuar ekonomike dhe punësimin. SKZH e QK-së 2016-2021 kërkon rritje të konkurrueshmërisë së sektorit privat, avancim të kapitalit njerëzor ku të rinjtë fitojnë arsimim i cili është adekuat për të përmbushur nevojat e sektorit privat, zvogëlim të ekonomisë informale, dhe zvogëlim të barrës administrative që rëndon mbi investimet private.

*Akterët vendor:* Misioni i USAID-it në Kosovë ka partneritete të qëndrueshme vendore me strukturat qeveritare siç janë Administrata Tatimore e Kosovës, Ministria e Ekonomisë, Punësimin, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, shoqatat e ndryshme të biznesit si Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, Oda Ekonomike e Kosovës, OSHC-të.

*Partneritetet inovative:* Misioni synon të zgjerojë fushëveprimin e “think tank”-eve të politikave vendore, shoqatave të biznesit dhe akterëve tjerë të sektorit privat për t’i identifikuar masat prioritare të politikave që adresojnë kufizimet madhore të konkureshmërisë së sektorit privat. Më tej, Misioni aktivisht po kërkon mënyra për të angazhuar diasporën në zhvillimin e sektorit privat të Kosovës.

*Baza e fakteve:* Vlerësimi PAD i Sektorit Privat, Diagnoza Sistematike e Vendit 2017 e Bankës Botërore, Studimi i Sektorit të TIK-ut (Maqedoni, Shqipëri, Kosovë) 2018, Analiza e Ekonomisë Politike e Kosovës 2017, dhe Analiza e Pengesave të Kosovës 2017 e MCC-së.

### **Rezultati i Ndërmjetëm 2.3: Përmirësohet siguria energjetike**

Një furnizim më i parashikueshëm dhe i besueshëm me energji elektrike do të çojë drejt produktivitetit të rritur të sektorit privat dhe investimeve të realizuara, të cilat do t’i krijojnë kushtet për një rritje të qëndrueshme ekonomike, më shumë mundësi për punësim dhe angazhim politik të qytetarëve të Kosovës.

Sektori energjetik i Kosovës është identifikuar përfundimisht si një pengesë ndaj rritjes nga disa vlerësime, përfshirë Vlerësimin e Sektorit Energjetik të USAID-it të vitit 2018 dhe Analizën e MCC-së të Pengesave të Kosovës të vitit 2017. QK ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme në sektorin energjetik që kanë patur për synim liberalizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë në Kosovë. Megjithatë, “bizneset kosovare bartin shpenzime shtesë që arrijnë shumën prej rreth 400 milion dollarë amerikan çdo vit si pasojë e furnizimit të parregullt me energji elektrike, sipas një studimi të USAID të vitit 2012.”<sup>51</sup> Sipas raportit mbi “Të Bërit Biznes 2013” të Bankës Botërore, ndikimi negativ i ndërprerjeve në furnizim me gjasë i kushton Kosovës rreth 5 përqind të BPV të saj.<sup>52</sup> Këto të dhëna i mbajnë IHD-të larg, ose i bëjnë investitorët e huaj të përcaktohen për ndonjë vend tjetër i cili jo domosdoshmërisht ofron avantazhin krahasimor të një rinie të gjallërishme që ka Kosova, të gatshme për të mësuar dhe punuar.

Si përgjigje, misioni i USAID-it në Kosovë do t’i sigurojë mbështetje teknike QK-së për t’i ndihmuar të rafinojë dhe zbatojë strategjinë e saj të energjisë. Në këtë drejtim, ndërhyrjet mund të përfshijnë mbështetje teknike për të gjeneruar energji elektrike nga burime të ndryshme, përfshirë edhe ato të ripërtëritshme. Në koordinim të ngushtë me Programin Rajonal për Ndihmë në Energji të Byrosë së USAID-it për Europë dhe Euroazi, misioni i USAID-it në Kosovë do t’i sigurojë Ministrisë së Energjisë mbështetje teknike dhe mbështetje në fushën e politikave për të lehtësuar integrimin e Kosovës në tregjet rajonale të energjisë. Përfundimisht, misioni i USAID-it në Kosovë do të promovojë gjenerimin e zgjëruar të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme të energjisë duke mbështetur zhvillimin e masave nxitëse të bazuar në treg për energji të

<sup>51</sup> Analiza e MCC e Pengesave në Kosovë, numër i cituar nga studimi i USAID I vitit 2012:

<https://assets.mcc.gov/content/uploads/Constraints-Analysis-Kosovo-1.pdf>

<sup>52</sup> Analiza e MCC e Pengesave në Kosovë: <https://assets.mcc.gov/content/uploads/Constraints-Analysis-Kosovo-1.pdf>

ripërtërishme, gjë e cila promovon furnizimin me energji më të pastër në përputhje me direktivat e BE-së, duke mos fryrë koston. Krahas kësaj, misioni i USAID-it në Kosovë do t'i koordinojë aktivitetet dhe bashkëpunojë ngushtë me MCC-në dhe agjencitë tjera të QSHBA në kërkim të mundësive për t'i komplementuar dhe shtuar përpjekjet në promovimin dhe avancimin e diversifikimit energjietik dhe fleksibilitetit të sistemit energjietik në Kosovë me synim të rritjes së investimeve që sjellin furnizim të sigurtë afatgjatë me energji. Në linjë me politikën e QSHBA, misioni i USAID-it në Kosovë "mbështet synimet europiane për të rritur sigurinë përmes diversifikimit të furnizimit me energji sipas furnitorit, rrugës dhe llojeve të lëndës nga e cila gjenerohet.

Pas rekomandimeve të Vlerësimit Gjinnor-LGBTI-Personave me Aftësi të Kufizuara, Misioni do të vazhdojë të mbështesë dhe institucionalizojë programet që angazhojnë gratë në sektorin energjietik për të zvogëluar edhe më tej pengesat kulturore që kanë të bëjnë me gjininë në energjietikë dhe për t'u ndihmuar grave të prosperojnë në këtë sektor. Si shembull i nismave të tilla në kuadër të strategjisë paraprake, në vitin 2018 misioni i USAID-it në Kosovë ndihmoi krijimin e Shoqatës së Grave në Sektorin e Energjisë të Kosovës (AWESK), ku anëtarët veprojnë në mënyrë ekipore si katalizator i ndryshimit të qëndrimeve ndaj grave që punojnë në sektorin energjietik të Kosovës.

*Lidhja me Politikën e Qeverisë së Kosovës:* QK mbetet e përkushtuar ndaj sigurimit të furnizimit me energji elektrike, uljes së konsumit të energjisë përmes masave të rritjes së efikasitetit të shfrytëzimit, dhe përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë në mënyrë racionale.<sup>53</sup> Misioni i USAID-it në Kosovë i pranon me një dozë kujdesi premtimet e QK-së, dhe përcjellë aktivisht përparimin e QK-se në bashkëpunim me partnerët tjerë, siç janë MCC, BE, etj.

*Akterët vendor:* Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Njësia për Implementimin e Projektit TC "Kosova e Re, " Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, dhe entitetet tjera të sektorit privat.

*Partneritetet inovative:* MCC, Banka Botërore, Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane për Zhvillim, dhe Zyra e BE-së në Kosovë.

*Baza e fakteve:* Vlerësimi i aktivitetit "Repower" dhe Vlerësimi i Sektorit Energjietik (2018), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë - Raporti Vjetor i Implementimit (2018), Raporti i "Të Bërit Biznes 2019" i Bankës Botërore, Profili i Ekonomisë së Kosovës i BB, dhe Ndikimi i furnizimit me energji elektrike në bizneset e Kosovës.

---

<sup>53</sup> Raporti Afatmesëm i Shpenzimeve , Kosovë 2019-2021: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/F41E6181-8CC0-4E79-A797-B5B5FEBCD82A.pdf>

## V. MONITORIMI, VLERËSIMI, DHE MËSIMI

Misioni do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e SKZHV-së për të kuptuar dhe mësuar se si i kontribuon ajo rrugëtimit të Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë dhe për të informuar korigjimet e kursit që mund të jenë të nevojshme gjatë kohëzgjatjes së strategjisë.

Në nivel global, të dhënat mbi Kosovën mungojnë në shumë të dhëna të pavarura nga palët e treta. Kjo paraqet një sfidë nga aspekti i Monitorimit, Vlerësimit dhe Mësimi (MVM) për Kosovën, meqë të dhënat e disponueshme për të informuar planifikimin strategjik në sektorin publik dhe atë privat janë të kufizuara. Udhërrëfyesve për VF 2019 dhe VF 2020 u mungojnë disa nga treguesit për Kosovën. Si përgjigje, Misioni ndihmoi në forcimin e bazës së fakteve të Kosovës duke financuar<sup>54</sup> përfshirjen e Kosovës nga Projekti i Drejtësisë Botërore (WJP) në matjen kuantitative të *Qeverisë së Hapur* për Udhërrëfyesit e ardhshëm. Tash e tutje, QK ka ndarë fonde për dhe do të bashkëpunojë me Projektin e Drejtësisë Botërore për të siguruar përfshirjen e Kosovës në këto matje çdo vit. Ky është një shembull i mundësisë për QK-në që të ndërtojë përkushtimin ndaj vendimmarrjes së bazuara në fakte për rrugëtimit të Kosovës drejt vetqëndrueshmërisë. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së strategjisë, Misioni do të vazhdojë të kërkojë mundësi për të inkurajuar përkushtimin vendor ndaj ndërtimit të bazës së fakteve dhe kultivimit të vetqëndrueshmërisë.

Përveç mangësive në njohuri të identifikuar në Udhërrëfyesit gjatë zhvillimit të SKZHV-së, Misioni identifikoi një numër pyetjesh mësimore prioritare të mundshme që mbeten të rafinohen më tej në Planin e Menaxhimit të Performancës (PMP). Së pari, Misioni është i interesuar të mësojë rreth qasjeve më efektive për të forcuar përkushtimin e qeverisë dhe sektorit privat ndaj planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të zgjidhjeve për sfidat zhvillimore të Kosovës. Së dyti, Misioni është shumë i interesuar të mësojë se si mund t'i inkorporojë në mënyrë më efektive gjetjet e vlerësimeve gjatë dizajnit të projekteve dhe aktiviteteve. Përfundimisht, Misioni do të hulumtojë mënyrat e identifikimit të qasjeve më të mira se si USAID-i mund t'i angazhojë sa më efektivisht të rinjtë e Kosovës.

## VI. ANEKSET

- a. Udhërrëfyesi i Vendit [VF2019](#) dhe [VF2020](#) për Rrugëtimit drejt Vetqëndrueshmërisë

---

<sup>54</sup> QK do të financojë vitet e ardhshme përfshirjen në Projektin Botëror të Drejtësisë për matjet vjetore të WJP në sundimin e ligjit.